



ЦРВЕН КРСТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА  
KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
MACEDONIAN RED CROSS



ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ  
RAPORTI VJETOR  
ANNUAL REPORT **2011**



# RAPORT VJETOR PËR VITIN 2011

*E PËRMIRËSOJMË JETËN  
PROMOVOJMË AKSION HUMANITAR*

## PËRMBAJTJA

SFIDA HUMANITARE.....	48
NDËRTIM TË SHOQATËS SË FORTË NACIONALE.....	50
IMPLEMENTIM TË QËLLIMEVE STRATEGJIKE TË STRATEGJISË 2020 TË KCRM-së.....	64
RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2011.....	84

## SFIDA HUMANITARE

Për liderët e një organizate me rëndësi të madhe është që të koncentrohen në vitin që ka kaluar që të nxirren përfundimet se çka është realizuar dhe të analizohen sfidat dhe trend me të cilat ballafaqohet organizata në vitin e kaluar. Këtë e bëjmë që të përmirësojmë performansat në fushat ku kemi pasur mangësi të caktuara, ta përhapim përfshirjen e shërbimeve tona, të përfshijmë më shumë persona, të bëjmë më shumë dhe më mirë, dhe të arrijmë më larg në pajtueshmëri me kontributet globale të Federatës ndërkombëtare dhe Planit Strategjik 2020 të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

Edhe pse ishim të ballafaquar me sfida të shumta, jemi përgjigjur me sukses në realizimin e prioriteteve dhe qëllimeve tona strategjike dhe në kuadër të mundësive tona dhamë kontribut të rëndësishëm në tejkalimin e problemeve të caktuara të përdoruesve tanë, dhe gjithashtu dhamë kontributin tonë të vogël në zhvillimin e përgjithshëm të vijimeve të përgjithshme në Republikën e Maqedonisë. Sfidat me të cilat ballafaqohemi vazhdimisht gjatë këtij viti duhet të na paraqesin nxitje për përsosjen e performansave tona në punë me qëllim që në periudhën që vjen të jemi më të suksesshëm dhe më të fortë që të mund të përgjigjemi në nevojat e përdoruesve tanë gjatë vitit 2012.

Vitin e shënoi implementimi i suksesshëm i më shumë projekteve dhe programeve të përkrahura nga Federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, Komiteti Ndërkombëtar, Kryqi i Kuq Gjerman, Kryqi i Kuq i Spanjës, Gjysmëhëna e Kuqe e Turqisë, Komisarati i Lartë për të Lkurit, Fondi Global, si dhe bashkëpunimi dhe raportet partnere me tre odat ekonomike, sektorin korporativ dhe organizatat joqeveritare në Maqedoni.

Ballafaqohemi me sukses me më shumë sfida në pjesën e sanimit të pasojave nga katastrofat natyrore të cilat kanë përfshirë më shumë rajone të vendit tonë, duke dhënë ndihmë për popullatën e goditur, si dhe sigurimin e trajnimeve për kategori të ndryshme të popullatës për përgatitje gjatë katastrofave. Programet dhe fushatat shëndetësore – preventive të shoqatës sonë nacionale, dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në preventivën e sëmundjeve dhe varshmërive dhe njohjen e popullatës me më shumë përmbajtje të cilat janë të rëndësishme për jetën e shëndoshë. Fushatat dhe aktivitetet sociale – humanitare me sukses u realizuan në të gjitha organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe kontribuuan në sigurimin e përkrahjeve të llojllojshme për më shumë kategori të popullatës së mjeruar në vendin tonë.

Vlerat dhe kontributet e organizatës sonë vazhdimisht u ndanë dhe promovuan në të gjitha mjediset shoqërore nëpërmjet orvatjeve avokative të Kryqit të Kuq para krerëve të ndryshëm përgjegjës në vend. Gjithashtu vazhdimisht punuam në promovimin e vlerave humane, ndërtimin e besimit dhe kuptimit reciprok, tolerancës dhe kulturës së dialogut posaçërisht tek gjeneratat më të reja.

Këtë vit e rumbullakësua realizimin e suksesshëm të planit trevjeçar për mbindërtim intensiv të kapaciteteve në fushat e përparimit të sistemit tonë informativ për menaxhim, menaxhimin e vullnetarëve dhe të punësuarve dhe mobilizimin e fondeve. Me rëndësi të madhe për ne mbetet që t'i vazhdojmë aktivitetet e shoqatës tonë nacionale në këtë plan nëpërmjet sigurimit të përkrahjes për donacion dhe zhvillim të formave të qëndrueshme për mbindërtimin e kapaciteteve. Sfidë plotësuese për ne ishte edhe mbajtje e suksesshme e mbledhjes partnere dhe sigurim të përkrahjes për projekte humanitare të organizatave tona komunale të Kryqit të Kuq nga ana e më shumë partnerëve nga shteti dhe jashtë vendit si dhe fillimi i procesit të certifikimit të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për shoqatë të fortë nacionale me çka e kaluam me sukses fazën e parë. Me rumbullakësimin e fazës së dytë në vitin 2012 shoqata e jonë nacionale do të haset me certifikatë për plotësimin e standardeve kualitative për shoqatë të fortë nacionale që shpresojmë se do të mundësojë përkrahje më të madhe donatore për Kryqin e Kuq të Maqedonisë për periudhën që vjen.

Përfitimet dhe realizimet janë rezultat i kontributeve dhe kontributi i vullnetarëve tanë të cilët vazhdimisht na përkrahin dhe së bashku me të punësuarit në organizatën e Kryqit të Kuq i realizuan të gjitha sfidat humanitare me çka ballafaqohemi dhe për të cilat shkruajmë në këtë raport. Falënderim edhe për të gjithë partnerët tanë të cilët vazhdimisht siguruan mbulesë për orvatjet tona që me sukses të përgjigjemi në të gjitha sfidat në vitin 2011.



D-r Millço Trajkov  
Kryetar



M-r Sait Saiti  
Sekretar gjeneral

## VITI I VULLNETARIZMIT NËN MOTON “GJEJE VULLNETARIN NË VETE”

Duke krahasuar botën në të cilën jetojmë sot me kohën kur është lindur ideja e Anri Dinan, do të shohim se qëllimet e punës humanitare nuk dalohen shumë, por gjendja e përgjithshme në botë është më e komplikuar që dedikon gjetje të qasjeve të reja për veprim efikas në të gjitha sferat e veprimit.

Skenat e filmit nga katastrofat që gjatë gjithë vitin na shokuan rrallë kush që do t'i harrojë: tërmete, cunami, vërshime, tornado dhe uragane morën dhjetëra mijë njerëz dhe lanë miliona njerëz pa kullm mbi kokë. Ata ishin sfidë për mobilizim plotësues të resurseve dhe përgjigje në kohë për lehtësimin e gjendjeve urgjente.

Vlerësimet thonë se Lëvizja e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe është rrjet global bërë 187 shtete me numër të përgjithshëm prej rreth 13,1 milion vullnetarë. Pothuajse në çdo gjendje krize me të cilat u ballafaqua vendi ynë, por edhe në tërë botën, njerëzit e parë të cilët u përgjigjen ishin vullnetarët. Njerëzit e moshave dhe profesioneve të ndryshme ndanin pjesë të kohës së tyre të lirë që t'u ndihmojnë atyre të cilët kishin nevojë për ndihmë, të bëjnë hapin e tyre në botën e cila vazhdimisht ndryshohet, drejtuar kah përmirësimi i jetës së popullatës së mjeruar.

Prandaj na nevojiten partneritete më aktive dhe qasje më e koordinuar, këmbim të përvojave dhe përgjigje në kohë me qëllim që të bëhet më shumë, të bëhet më mirë dhe të arrihet më larg.

Kryqi i Kuq i RM-së e shënonte dhe vazhdimisht e promovonte vitin 2011, si vit Evropian i vullnetarëve në kuadër të fushatës së Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe nën moton “Gjeje vullnetarin në vete”. Njëpërmjet organizimit të aktiviteteve të shumta patëm sukses të rekrutojmë gjithsej 1.414 vullnetarë të rinj të cilët shpresojmë se do të bëhen aktiv dhe përkrahës afatgjatë të aktiviteteve të Kryqit të Kuq.

Njëpërmjet implementimit të programit gjatë tërë vitit e promovuam vullnetarizmin dhe punën vullnetare njëpërmjet së cilës u rrit interesi tek qytetarët, janë afruar vullnetarë të rinj dhe aktivitete të reja, është rritur interesi i sektorit korporativ për bashkëpunim me Kryqin e Kuq, janë përfunduar resurset njerëzore, është përmirësuar bashkëpunimi me sektorin jo-



qeveritar, është siguruar ndihmë e madhe për numër të madh të familjeve me çka janë përfshirë një numër i madh i përdoruesve.

Mirënjohje për angazhimin dhe kontributin e tyre, si dhe nevoja për përparimin e punës vullnetare paraqet edhe rezoluta e miratuar në Konferencën Ndërkombëtare të Lëvizjes së Kryqit të Kuq që u mbajt në vitin 2011 në Gjenevë, me të cilën thirren shtetet ta revidojnë legjislativën ekzistuese e cila e rregullon vullnetarizmin në vend e vet me qëllim nxitjen dhe krijimin e mjedisit që mundëson.





## NDËRTIMI I SHOQATËS SË FORTË NACIONALE

### Mbledhja e tretë partnere

Në periudhën prej 31 Maj deri më 2 Qershor 2011 u mbajt mbledhja e tretë partnere e Kryqit të Kuq të RM-së në Strugë. Mbledhja kishte për qëllim të mundësojë përmirësim të kapaciteteve në pjesët integrale të shoqatës nacionale, përparim të bashkëpunimit me shoqata nacionale në kuadër të Lëvizjes, promovim të përgjegjësisë shoqërore të kompanive në RM-së, ngritje të imazhit të Kryqit të Kuq dhe mobilizim të kompanive në RM-së, ngritje të imazhit të Kryqit të Kuq dhe mobilizim të fondeve. Për qëllimet e mbledhjes partnere u përgatitën 35 projekte të organizatave komunale të KK, organizatës së qytetit të KKRM-së dhe qendrës së shoqatës nacionale. Në mbledhjen partnere morën pjesë përfaqësues të ambasadave në Republikën e Maqedonisë, shefi i Zonës së Federatës Ndërkombëtare, përfaqësues të shoqatave nacionale, agjenci ndërkombëtare, ministrinë të Qeverisë së RM-së, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe përfaqësues të sektorit korporativ dhe odave ekonomike të RM-së. Të pranishmëve iu prezantua puna e shoqatës nacionale në periudhën e kaluar, arritjet kryesore dhe sfidat në punë, përvojat e mëparshme të dy mbledhjeve të para partnere, dhe gjithashtu iu prezantuan edhe 35 projekte dhe rezultatet e pritura përdërisa janë implementuar në Republikën e Maqedonisë. Në mbledhjen partnere një pjesë e madhe e mysafirëve të pranishëm shprehën kënaqësi nga bashkëpunimi i deritanishëm dhe shprehën gatishmëri për financimin e projekteve të caktuara.



### Procesi i certifikimit për shoqata të forta nacionale

Si rezultat i arritjeve në periudhën e kaluar në sferën e zhvillimit organizativ dhe mbindërtimit e kapaciteteve, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë morri pjesë në mbledhjen konsultative për përgatitjen e kornizës për zhvillimin e shoqatave të forta nacionale që u mbajt më 1 deri 2 mars të vitit 2011 në Budapest, Hungari në organizim të Federatës Ndërkombëtare. Qëllimi i mbledhjes ishte këmbimi i informacioneve dhe përshtatja e ideve lidhur me kornizën e re për zhvillimin e shoqatave nacionale, në përputhshmëri me Strategjinë 2020. Kah mesi i vitit 2011 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë ishte ftuar që të marrë pjesë në pilot fazën e procesit për certifikimin e kapaciteteve organizative të shoqatave nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe të cilën e realizon Federata Ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i procesit për vlerësimin organizativ të kapaciteteve dhe certifikimit është që t'u mundësohet shoqatave nacionale t'i vlerësojnë kapacitetet dhe punët e veta me qëllim që të vërtetohen qasjet më të mira për zhvillim individual, si dhe të jepet vërtetim për ato shoqata nacionale të cilat kanë arritur nivel të lartë të kompetencës. Procesi për vlerësim organizativ të kapaciteteve dhe certifikimit është proces kompleks i përbërë prej dy vlerësimeve të posaçme. Njëri është vetëvlerësim, ndërsa tjetri është vlerësim i ekipit të jashtëm për vlerësim. Të dy vlerësimet janë të shoqëruar me mjete gjithëpërfshirëse të intervenimeve organizativo – zhvillimore, të cilat janë të thurura të tregojnë kapacitete specifike deficitare të cilat identifikohen gjatë vlerësimeve. Përfaqësues të Kryqit të Kuq të Maqedonisë morën pjesë në

dy mbledhje instruktive në Gjenevë në qershor dhe shtator. Faza e parë e procesit të certifikimit u realizua në periudhën shtator – tetor ku mori pjesë grupi punues i përbërë prej 12 përfaqësuesve të udhëheqësive dhe drejtorisë të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Në prani të dy përfaqësuesve të Sekretariatit të Federatës Ndërkombëtare, vetëvlerësimi i shoqatës nacionale u realizua në periudhën prej 22 deri 25 tetor në Strugë me çka KKRМ-së u notua me notë pozitive për të gjithë 90 treguesit për sukses në punë. Gjatë kohës së vizitës, përfaqësuesit e Federatës Ndërkombëtare gjithashtu e vizituan edhe Qendrën e Kryqit të Kuq të RM-së, Kryqin e Kuq të qytetit të Shkupit, Kryqin e Kuq të Kumanovës dhe Kryqin e Kuq të Ohrit. Faza e dytë e procesit të certifikimit do të realizohet në vitin 2012 dhe përderisa rumbullakësohet me sukses, do të vijon marrje e certifikatat për shoqatën të fortë nacionale.

## Planifikimi strategjik si bazë për vendosje të drejtë

Planifikimi strategjik paraqet proces ku përcaktohen prioritetet dhe qëllimet të cilat llogariten për më të rëndësishme dhe definojnë programet, projektet dhe aktivitetet, nëpërmjet të cilave do të realizohen prioritetet e definuara për realizimin e programeve individuale. Gjatë vitit 2011 Kryqi i Kuq i RM-së përpunoi katër plane strategjike për veprimtari individuale në pajtueshmëri me qëllimet e Planit Strategjik 2020 të KKRМ-së.

- Plani strategjik për veprimtari shëndetësore – preventive për vitin 2011 – 2015;
- Plani strategjik për veprimtari sociale – humanitare për vitin 2011 – 2015;
- Plani strategjik për rininë për vitin 2011 – 2015;
- Plani strategjik për diseminim për vitin 2011 – 2015.

Këto dokumente paraqesin kornizë zhvillimore për katër fushat programore ku janë prezantuar prioritetet zhvillimore dhe qëllimet strategjike për periudhën pesëvjeçare që vijon.

## Partneritet dhe rol ndihmës – Memorandume të nënshkruara për bashkëpunim

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të raporteve me partnerët dhe përkrahësit e vet gjatë vitit 2011 Kryqi i Kuq i RM-së nënshkroi memorandum për bashkëpunim me:

- Këshillin republikan për siguri në komunikacionin rrugor;
- Bashkësinë e njëjseve të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë;
- Komitetin olimpiq të Maqedonisë;
- Spitalin special “Filipi i dytë”;
- Fakultetin për siguri – Shkup pranë Universitetit “Sh. Qirili dhe Metodi” – Manastir;
- Fakultetin për edukatë fizike – Shkup pranë Universitetit “Sh. Qirili dhe Metodi” – Shkup;
- Universiteti FON
- Konzorciumin DETRA Qendra Shkup dhe Biznes Akademinë Smilevski – BAS – Shkup.





## Ndihmë për partnerët tanë në kuadër të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe

Tërmeti katastrofal dhe cunami që goditën Japoninë, si dhe tërmeti i fortë i cili e goditi provincën lindore Van në Turqi, paraqitën dëme të mëdha materiale dhe humbje njerëzore. Në shenjë solidariteti Kryqi i Kuq i RM-së u kyç në apelin të cilin e shpalli Federata Ndërkombëtare e Lëvizjeve të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, nëpërmjet shpalljes së apeleve për grumbullimin e mjeteve financiare për të ndihmuar popullatën e goditur dhe sanimin e dëmeve materiale. Në aksionin për të ndihmuar popullatën e goditur nga tërmeti në Japoni nga ana e qytetarëve dhe kompanive të Maqedonisë u siguruan gjithsej 817.864 denarë, përderisa nëpërmjet apelit për ndihmë në Turqi u siguruan 1 500 000 denarë për grupet adekuate qëllimore.

## Rol avokativ dhe komunikim

Kryqi i Kuq i RM-së në punën e vet duke mbrojtur interesat e grupeve të mjeruara të qytetarëve u angazhua për sjelljen e dokumenteve nacionale, si strategjitë, platformat, planet dhe programet zhvillimore në pajtueshmëri me nevojat e tyre. Në kuadër të veprimit tonë nëpërmjet partneriteteve, grupeve për përkrahje, bashkëpunimeve të drejtpërdrejta dhe anëtarësimeve në trupat nacional në fushat e veprimit në mënyrë aktive kyçemi në procesin e sjelljeve të vendimeve.

Në vitin 2011 KKRМ-së i përfaqësonte interesat e grupeve qëllimore nëpërmjet Komitetit Internacional për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare, si trup ndërkombëtar me seli në Kryqin e Kuq të RM-së, pjesëmarrje në Sekretariatin e Komisionit Internacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe integritit ilegal, pjesëmarrje në debatet publike për sjelljen e Ligjit për të rinj në nivel shtetëror etj. Gjatë vitit të kaluar KKRМ-së i përfaqësonte interesat edhe të grupeve të marginalizuara nëpërmjet projektit për mbajtjen e prevalencës së ulët të HIV në Republikën e Maqedonisë me realizim të tre punëtorive në nivel lokal në Veles, Kërçovë dhe Prilep. Punëtoritë ishin të dedikuara për sjellësit e vendimeve me qëllim uljen e diskriminimit të përdoruesve të mjeteve narkotike nga ana e institucioneve shtetërore. Në kuadër të projektit përkujdesje për personat e moshuar organizata komunale e Kryqit të Kuq Veles zbaton përkrahjen nga vetëqeverisja lokale në pjesë të aktiviteteve të drejtuara kah përkujdesja për personat e moshuar.

Një shoqëri e fortë dhe e organizuar qytetare promovon veten në ndërmjetësues të suksesshëm nëpërmjet të cilës njerëzit mund t'i shprehin mendimet dhe qëndrimet e veta dhe të organizohen për zgjedhjen e problemeve për të cilat kanë interesim.



## PËRCAKTIME ZHVILLIMORE PËR MODERNIZIMIN E SHOQATËS NACIONALE

**Ndërtim të standardeve organizative – mbindërtim intensiv të kapaciteteve** – Në vitin 2011 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë i rumbullakësoi aktivitetet nga faza e tretë përfundimtare të projektit për mbindërtim intensiv të kapaciteteve (MIK) përkrahur nga Federata Ndërkombëtare. Ky projekt trevjeçar kontribuoi për zhvillimin e kapaciteteve materiale – teknike dhe kadrovike të organizatës në nivel komunal dhe shtetëror duke i mundësuar Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë që me sukses të ballafaqohet me sfidat me të cilat ballafaqohet popullata e mjeruar në bashkësitë lokale.

Aktivitetet projektuese u implementuan në tre fusha programore dhe atë: ndërtim i sistemit efikas informativ menaxhues, menaxhim i vullnetarëve dhe të punësuarve dhe mobilizim të fondeve. Faza e tretë përfundimtare e projektit trevjeçar u përmbyll në qershor të vitit 2011. projekti i përfshiu të gjitha 34 organizatat komunale dhe organizatën qytetare të Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit.

## ANGAZHIM PËR BASHKËSITË DHE VULLNETARIZMI

**Menaxhim me vullnetarë** – Kryqi i Kuq i RM-së kontribuon në sigurimin e sistemit stabil për tërheqjen, edukimin, veprimin në teren dhe mbajtjen e vullnetarëve. Në vitin 2011, Rrjeti interesant për menaxhim vullnetar ka punuar në këmbimin e përvojave, koordinimin dhe përcjelljen e projekteve të organizatave komunale të KK për rritjen e numrit të vullnetarëve, me çka u përpunua dokument i rëndësishëm – Politika për tërheqjen, mbajtjen dhe përcjelljen e vullnetarëve.

Në periudhën janar – maj të vitit 2011 me sukses u implementuan 13 projekte të vogla të OKKK për rritjen e numrit të vullnetarëve dhe për të ndihmuar popullatën e mjeruar, të kyçur në fazën e dytë dhe të tretë të projektit MIK për menaxhim me vullnetarë, nëpërmjet së cilit u bashkëngjiten dhe u kyçen në punën e OKKK gjithsej 791 vullnetarë.

Në kuadër të ueb faqes së redizajnuar në pjesën e dytë të vitit 2011 filloi të funksionojë fusha elektronike për paraqitjen e vullnetarëve dhe anëtarëve “Bëhu pjesë” – “Bëhu vullnetar” ku secili ka mundësi të paraqitet, në përputhje me vendbanimin dhe interesat e tij. Në periudhën gusht – dhjetor të vitit 2011 u paraqitën gjithsej 91 vullnetarë/anëtarë të rinj në KKRMsë.



## BASHKËPUNIM DHE NDARJE TË RESURSEVE



### Bashkëpunim dhe iniciativa të përbashkëta me sektorin korporativ

– Përvojat pozitive në punën me kompani të suksesshme në Republikën e Maqedonisë treguan se kompanitë kanë interes dhe gatishmëri për bashkëpunim dhe përkrahje në organizimin dhe realizimin e fushatave dhe aksioneve të KK. Dispozitat të cilat dalin si rezultat i politikave të reja në fushën e mobilizimit të resurseve dhe fondeve të sektorit korporativ, Kryqi i Kuq i RM-së bëri riorganizim të brendshëm me qëllim që në mënyrë më të organizuar të prijë në përdorimin e kapaciteteve dhe mundësi personale dhe të njëjtat t'i fusë në funksion si partner serioz të kompanive, në implementimin e programeve të përbashkëta sociale të dobishme për përmirësimin e kualitetit të jetës të popullatës së mjeruar në bashkësi. Njëkohësisht Kryqi i Kuq punoi në sjelljen e reformave të reja për nxitjen e interesit të sektorit korporativ për përkrahjen e aktiviteteve të KK, nëpërmjet së cilit është sjellë modeli fleksibil në bashkëpunim me kompanitë. Përbajtjet e përpunuara projektuese iu ofruan kompanive me mundësi që të njëjtat të modifikohen në përputhshmëri me interesin e kompanive për veprim të përbashkët në bashkësi. Nga evaluimi i bërë në aktivitetet e implementuara mund të vlerësohen efekte pozitive dhe kënaqësia e përdoruesve të shërbimeve për ndihmën dhe përkrahjen e siguruar me të cilat janë përfshirë mbi 7000 persona (popullata e re, personat e moshuar, personat me nevoja të posaçme, persona të cilët janë të ballafaquar me rrezik të caktuar social), si dhe popullata në përgjithësi ku ndikonte për ngritjen e vetëdijes për përkrahjen dhe ndihmën e nevojshme të grupeve të mjeruara qëllimore. Në implementimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë aktive morën pjesë edhe një numër i madh i të punësuarve nga kompanitë me çka e vërtetuan përgjegjësinë e tyre sociale.

### Falënderim për bashkëpunimin dhe përkrahjen e realizuar

– Më 21 dhjetor KKRМ-së organizoi takim me përfaqësuesit e odave ekonomike dhe kompanitë ku u tregua falënderim për bashkëpunimin dhe përkrahjen e siguruar gjatë vitit 2011. në takimin morën pjesë përfaqësues të më shumë kompanive të rëndësishme, si dhe përfaqësues të tre odave ekonomike në Maqedoni, të cilave nga ana e m-r Saiti Sekretar gjeneral i KKRМ-së iu dorëzuan falënderime për bashkëpunimin e realizuar me Kryqin e Kuq. Gjatë vitit u përkrahën aktivitete dhe iniciativa të përgjithshme në interes të grupeve të ndryshme qëllimore: aktivitete për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme, për përforcimin e kapaciteteve të grupeve të mjeruara qëllimore për integrim më të mirë social në bashkësi, për ngritjen e vetëdijes publike për të ndihmuar dhe kujdesur personat e moshuar, u organizuan aksione për dhurimin e gjakut dhe donacione për grupet e mjeruara qëllimore në bashkësi dhe shumë aktivitete humanitare.

Banka Komerciale SHA Shkup	Përkrahje e "Projekt për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme" implementuar mbi 9 organizata komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit;	Fondacioni T-Mobile Maqedoni	Është siguruar numër telefoni pa pagesë për donacione;
EVN Maqedoni SHA	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Përkrahje e Projektit "Zhvillim i përbashkët i bashkësisë" në bashkësinë e mjeruar rromë në Shuto Orizare për sigurimin e përkrahjes dhe përforcimin e kapaciteteve të grupeve të mjeruara qëllimore;</li> <li>•Përkrahje në shënimin e "Java e kujdesit për personat e moshuar" – gjilpëra të siguruar dhe lenta pa pagesë për matjen e sheqerit në gjak të 2000 personave të moshuar, botim të materialit promovues (postere dhe fletushka);</li> <li>•Është implementuar aksion i përbashkët humanitar për ndarjen e paqetave për 600 fëmijë me nevoja të posaçme dhe për fëmijët e familjeve të rrezikuara sociale me rastin e vestave të vitit të ri;</li> </ul>	ONE	Është siguruar numër telefoni pa pagesë për donacione; Përkrahje në aktivitetet e KK të qytetit të Shkupit, donacion të 83 telefonave celular në kuadër të projektit për kujdesin e personave të moshuar në kushte shtëpiake;
		Operatori VIP	Është siguruar numër telefoni pa pagesë për donacione;
		SHA ALKALOID Shkup	Mjete të siguruar për higjienë për nevojat e Pikës për pastrehimorët pranë KK të qytetit të Shkupit nëpërmjet së cilës sigurohet përkrahje për personat pa strehim në Shkup;
Stopanska Banka SHA Shkup	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Aksion humanitar i organizuar me të punësuarit e Stopanska Banka – donacion të 5 ton veshmbathjeve, mbulesave, librave dhe gjëra për shtëpi;</li> <li>•Përkrahje e aksionit për dhurimin e gjakut me rastin e 13 Nëntorit, të organizuar nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit – 200 xhaketa të siguruar për dhuruesit e gjakut;</li> <li>•Vizitë të Qendrës në Shuto Orizare – donacion të atleteve dhe paqeta për vitin e ri për 40 fëmijë të kërkuesve të azilit dhe për fëmijët e bashkësisë;</li> </ul>	Sigurimi SAVA SHA Shkup	Përkrahje në organizimin e garës nga ndihma e parë të organizuar nga KK i qytetit të Shkupit dhe donacion defibrilatorë, barëra për pikën për personat e pastrehë;
		SHA OKTA Shkup	Mjete të dhuruar në "Java e solidaritetit" nga ana e të punësuarve në kompaninë dhe paqeta të furnizuara me ushqim;
		Studio Moderna	Aksion i përbashkët i organizuar humanitar – shtretër të siduruar dhe mjete për furnizimin e inhalatorit për fëmijët e sëmurë nga fibroza cistike;
Alfa banka SHA Shkup	Është implementuar iniciativa e përbashkët për sigurimin e 100 paqetave me ushqim për popullatën e mjeruar;	Spitali i specializuar Filipi i Dytë	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Kamp veror i realizuar për fëmijët e lindur me sëmundje të zemrës, anomali dhe për prindërit e tyre nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit;</li> <li>•Përkrahje në implementimin e aktiviteteve preventive shëndetësore të KK të qytetit të Shkupit;</li> <li>•Karvan edukativ i organizuar në disa qytete në bashkëpunim me OKKK për rreziqet dhe masat për mbrojtje nga valët e nxehta;</li> </ul>
Banka e Ohrit SHA Ohër - Societe Generale Group	Është implementuar iniciativë e përbashkët për sigurimin e mjeteve për furnizimin e dy inhalatorëve për fëmijët me fibrozë cistike dhe të donuar në Klinikën për sëmundje të fëmijëve dhe të dorëzuar Shoqatës për fibrozë cistike;		
SHA Postat e Maqedonisë	Përkrahje për fushatën "Dita e urisë" – aksion për ndihmën e popullatës së mjeruar – dorëzim pa pagesë të fletushkave në kompanitë e RM-së.	Korea Auto Trejd	Përkrahje e Projektit dedikuar për përkrahjen psiko-sociale për fëmijët e lindur me sëmundje të zemrës;

## Ekipe projektues i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë për përgatitjen e aplikimeve projektuese për fondet e Bashkimit Evropian

- Në fillim të vitit 2011 u formua ekip projektues për përgatitjen e aplikimeve projektuese për sigurimin e fondeve nga Bashkimi Evropian. Formimi i ekipit projektues doli nga nevoja për sigurimin e përkrahjes plotësuese financiare për realizimin e aktiviteteve programore dhe projektuese të KKRМ-së. Ekipi gjatë tërë vitit i përcillte thirrjet e BE dhe mori pjesë në sesionet informative të cilat mbaheshin në BE, indo qendrën, dhe gjithashtu anëtarët e ekipit projektues kaluan trajnimin për të shkruar aplikimet projektuese për Fondet e BE. Gjatë vitit 2011 KKRМ-së aplikoi me tre propozim aplikime në Fondet e BE për programet PROGRESS (punësim dhe solidaritet social) dhe Instrumentin Evropian për Demokraci dhe Të Drejtat e Njeriut. Për nevojat e aplikacioneve KKRМ-së e zgjeroi bashkëpunimin partneror me institucionet shtetërore dhe së bashku aplikoi me Entin për punë sociale Shkup dhe qytetin e Shkupit dhe KK të Gjermanisë në fondet evropiane.

## KOMUNIKIM DHE TRANSPARENÇË NË PUNË

**Sistemi informativ menaxhues** -Zhvillimi i sistemit informativ për menaxhim dhe komunikim në kuadër të shoqatës nacionale paraqet një ndër prioritetet kryesore të procesit për mbindërtim intensiv të kapaciteteve (MIK) që mundëson rrjedhje të shpejtë, të lehtë, kapshme, efikase dhe strukturale të informacioneve në shoqatën nacionale në të gjitha fushat programore.

Në kuadër të aktiviteteve të planifikuara në vitin e tretë MIK, u furnizuan serverët harduer të planifikuar për menaxhim me sistemin informativ. Gjithashtu u siguria përsosja dhe instalimi i softuerit për menaxhim me sistemin informativ të KKRМ-së. U siguria përpunim, azhurim dhe ndërrim të moduleve softuerike për evidentimin e vullnetarëve dhe anëtarëve, ndihmë e parë, dhurimin e gjakut, punës zyrtare, modulit për qendrën e trajnimit të KKRМ-së dhe modul për programin për katastrofa. Këto zgjedhje softuerike mundësojnë komunikim elektronik në kuadër të kornizave të shoqatës nacionale dhe përpunimin e të dhënave për veprimtaritë programore, analizim, shumim dhe qasje adekuate dhe kontroll në punë.

Gjatë vitit raportues, në bashkëpunim me kompaninë konsultative "Novkom", u mbajtën pesë trajnime në Shkup për të punësuarit dhe vullnetarët e KK me qëllim që të përdoret me sukses sistemi informativ për menaxhim me të cilin u përfshinë rreth 70 persona. Gjithashtu, u realizuan vizita në tere të OKKK me qëllim sigurimin e trajnimit praktik për përdorimin e softuerëve nga ana e të punësuarve dhe vullnetarëve të tyre.



**Marrëdhënie me publikun** - Marrëdhëniet me publikun janë pjesë e angazhimit të përgjithshëm të menaxhimit për informim dhe përmirësim të imazhit të punës së Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

Botimet javore të gazetës elektronike të KK, tanimë në mënyrë tradicionale paraqesin shembull të mjetit të suksesshëm për informimin e vullnetarëve tanë, partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe përkrahësit për aktivitetet të cilat i realizojmë në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Në vitin 2011 u përgatitën 45 numra E-gazeta INFO të KKRМ-së me gjithsej 368 tekste të botuara të dërguara në mbi 67 432 e-mail adresa në bazë ditore.

Ridizajnimi dhe mbindërtimi i internet faqes së KKRМ-së mundësoi hapësirë për shpalljen e një numri më të madh të informacioneve të llojllojshme, interaktive të shpallura në gjuhën maqedonishte, shqipe dhe angleze struktura e secilës targjeton kategori të ndryshme të vizitorëve. Në kuadër të ueb faqes së re është hapur fushë e re për bashkëpunim korporativ për promovimin e iniciativave të përbashkëta me sektorin korporativ dedikuar për përmirësimin e kualitetit të jetës së popullatës së mjeruar.

Javët tradicionale të definuara me ligjin për Kryqin e Kuq, si dhe një numër i madh i projekteve dhe dokumenteve strategjike në kuadër të veprimtarisë botuese të shoqatës nacionale, edhe këtë vit rregullisht u plotësuan me materiale kreative dhe atraktive edukative në formë të broshurave, fletushkave, postareve, doracakëve, triskave me pagesë shtesë dhe lloje të tjera të botimeve të përpunuara në gjuhën maqedonishte dhe shqipe,

Nëpërmjet shpalljeve për botim, konferenca shtypi dhe ngjarjeve publike në mediat elektronike, mjete për informim publik vazhdimisht ishin të pranishëm gjatë realizimit të aktiviteteve të KKRМ-së. Në shenjë falënderimi, Kryqi i Kuq i RM-së ndau falënderime TVRM-së, TV SITEL, Kanal 5, TV ALSAT – M, TV TELMA, TV ALFA, TV ERA, TV MTM, VEÇER për bashkëpunimin dhe përkrahjen e realizuar në vitin 2011, të cilat medime kontribuan në promovimin e aktiviteteve humanitare të realizuara të Kryqit të Kuq.

## SHOQATË NACIONALE E CILA FUNKSIONON MIRË

### C – BAR zbatimi i metodës së re për vlerësim dhe vetëvlerësim të shoqatave nacionale

**-Pas zbatimit të suksesshëm të procesit C – BAR në nivel nacional në vitin 2010 dhe gjatë vitit 2011 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në mënyrë eksperimentale e zbatoi procesin C – BAR të vlerësimit dhe vetëvlerësimit edhe në nivel komunal. Me vlerësimin u përfshinë pjesa më e madhe e organizatave komunale të Kryqit të Kuq të Maqedonisë.**

Grupi i parë i 13 OKKK u përfshi me punëtorinë e cila u mbajt në periudhën 25 deri më 27 maj të vitit 2011, në Qendrën për edukimin e kadrove në Strugë ku u mbajt në kuadër të përkrahjes globale të Komitetit Ndërkombëtar të KK drejtuar kah mbindërtimi i kapaciteteve të shoqatës nacionale. Grupi i dytë prej 12 organizatave komunale u përfshinë me procesin C- BAR në muajin qershor të vitit 2011.

Nëpërmjet vetëvlerësimit C-BAR që bazohet në dëshmi dhe është dizajnuar të masë shkallën e suksesit në punën e organizatës në katër domene dhe 13 dimensione në pjesën e mbindërtimit të kapaciteteve, Kryqi i Kuq i Maqedonisë zbatoi vlerësim të një pjesë të madhe të organizatave komunale të KK me çka siguroi tregues për suksesin e implementimit të programit për mbindërtim intensiv të kapaciteteve në tre vitet e kaluara, si dhe shqyrtime gjenerale për përparimin e shoqatës nacionale në fushën e mbindërtimit të kapaciteteve.



# FUNKSIONIM EFIKAS NË KUADËR TË LËVIZJES NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE – Ngjarje ndërkombëtare

Gjatë vitit 2011 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë realizoi një mori aktivitete në plan ndërkombëtar dedikuar kah sigurimi i mjeteve programore dhe projektuese për mbindërtimin e kapaciteteve të reja, ndarjen e përvojave dhe diturive pozitive dhe përparim të bashkëpunimit bilateral me shoqata nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe organizata tjera ndërkombëtare dhe agjenci. Përfaqësues të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë morën pjesë në më shumë konferenca ndërkombëtare, seminare, mbledhje, trajnime dhe kampe rinore. Aktivitetet ndërkombëtare për veprimtari janë pjesë integrale të këtij raporti.



## Konferenca ballkanike e XVII-të e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe

-Në Bukuresht, Rumania në periudhën 20 – 23. 09. 2011 u mbajt Konferenca Ballkanike e XVII-të e shoqatave nacionale e KK/GJHK, ku morën pjesë përfaqësues të shoqatave nacionale të Maqedonisë, Rumanisë, Bullgarisë, Turqisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Shqipërisë përderisa si mysafirë ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga Kroacia, Sllovenia, Austria, Suedia, Britania e Madhe, Italia, Gjermania, Moldavia, Federata Ndërkombëtare dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Në konferencë u këmbyen përvoja në më shumë tema: plakje aktive të popullatës, migrime të popullatës, menaxhim me katastrofa, mobilizim të resurseve, përkrahje psiko-sociale dhe vullnetarizmi në Kryqin e Kuq. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në konferencë ishte prezantuar nga ana e delegacionit dy anëtarësh të udhëhequr nga kryetari i KCRM-së, D-r Millço Trajkov.



## Mbledhje statutare të Lëvizjes

-Në periudhën prej 23 nëntor deri më 01 dhjetor të vitit 2011, delegacion i KCRM-së prej tre anëtarëve mori pjesë në mbledhjet statutare të Lëvizjes ku morën pjesë 180 shoqata nacionale dhe që u mbajtën në Gjenevë, Zvicër. Kuvendi gjeneral i Federatës Ndërkombëtare u mbajt prej 23 deri më 25 nëntor dhe në të u miratuan më shumë dokumente të rëndësishme për veprim për veprim të mëtutjeshëm të Federatës. Kuvendi gjeneral e e miratoi raportin për punë për periudhën 2009 – 2011 së bashku me raportin financiar, si dhe programin për punë me planin financiar për dy vitet vijuese. Këshilli i delegatëve u mbajt më 26 nëntor të vitit 2011 dhe i njëjti i mblodhi së bashku shoqatat nacionale, Federatat Ndërkombëtare dhe Komitetin Ndërkombëtar. Në të njëjtin u miratuan politika dhe strategji të reja dhe u zhvilluan diskutime të cilat kanë të bëjnë me sfidat më të mëdha humanitare të kohës së tanishme.

**Konferenca e 31 Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe** - U mbajt prej 27 nëntor deri më 01 dhjetor të vitit 2011. në konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të shteteve nënshkruese të Konventës së Gjenevës, ndërsa nga Republika e Maqedonisë mori pjesë edhe ambasadori i RM-së pranë Misionit të Vazhdueshëm të RM-së në Gjenevë, z. Aziz Pollozhani. Në mbledhjet plenare pjesëmarrësit në Konferencë diskutuan në më shumë tema, siç janë implementimi i memorandumit për kuptim mes Gjysmëhënës së Kuqe të Palestinës dhe Yllit të Davit Meganit, implementimin e Deklaratës “Së bashku për humanizëm”, implementim të rezolutave dhe kontributeve të Konferencës së 30-të Ndërkombëtare, si dhe për përparimin e ligjeve për përkrahje gjatë katastrofave. Gjatë konferencës u mbajtën sesione të komisioneve me temë: migrime, roli ndihmës i shoqatave nacionale, kujdes shëndetësor pranë situatave urgjente, respektim dhe mbrojtje të shëndetit gjatë konflikteve të armatosura dhe situatave tjera të dhunës dhe uljen e shëndetit joadekuat. Në Konferencën Ndërkombëtare u zgjodh Komisioni i Vazhdueshëm i ri prej shtatë anëtarëve me të cilën do të udhëheqë Greg Vikeri nga KK i Australisë. Gjatë mbledhjeve statutare u mbajtën më shumë takime bilaterale me përfaqësuesit e delegacioneve të shoqatave nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuq. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë fitoi mirënjohje të posaçme nga Kryqi i Kuq i Japonisë, si dhe falënderim për ndihmën e siguruar humanitare për popullatën e mjeruar në Japoni në tërmetin katastrofal dhe cunamin që e goditën Japoninë. Falënderimi iu dorëzua Sekretarit gjeneral Sait Saiti nga ana e Kryetarit të Federatës Ndërkombëtare, Tadateru Konoe.

## BASHKËPUNIM NË KUADËR TË LËVIZJES NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

**Vizita e delegacionit të Zonës Evropiane të Federatës Ndërkombëtare të lëvizjeve të KK dhe GJHK** -Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Federatën Ndërkombëtare të KK dhe GJHK, u vizitua nga ana e delegacionit dy anëtarësh të Zonës Evropiane të Federatës Ndërkombëtare nga Budapesti të udhëhequr nga shefi i zonës, z-nja Anitta Underlin. Nga ana e Kryqit të Kuq të Maqedonisë u prezantua puna e shoqatës nacionale, si dhe aktivitetet për rritjen e efikasitetit dhe promovimit të inovacioneve në rekomandim të shërbimeve nga ana e KKRMs-së. Në kuadër të vizitës përfaqësuesit e lartë të Zonës Evropiane të Federatës Ndërkombëtare të shoqatave të KK dhe GJHK morën pjesë në Mbledhjen partnere të KKRMs-së që u mbajt në Strugë në periudhën prej 31 maj – 2 qershor 2011.

### **Vizita e zonjës Mechthild Richert, bashkëpunëtor rajonal për Evropë nga Kryqi i Kuq të Gjermanisë**

- Në periudhën 31 maj – 2 qershor të vitit 2011 KKRMs-së u vizitua nga zonja Mechthild Richert, bashkëpunëtor rajonal për Evropë nga Kryqi i Kuq i Gjermanisë. Gjatë vizitës përfaqësuesi i Kryqit të Kuq të Gjermanisë realizoi disa takime në Shkup, gjithashtu mori pjesë edhe në mbledhjen partnere. Më 31 maj zonja Rihert realizoi takim me Sekretarin gjeneral Sait Saitin, me çka Sekretari gjeneral e theksoi ndihmën e KK të Gjermanisë gjatë krizave në Maqedoni, duke potencuar se edhe populli i Maqedonisë e njeh KK e Gjermanisë mu për këtë përkrahje. Z-nja Rihert e potencoi kënaqësinë e bashkëpunimit të deritanishëm, e posaçërisht për llogaridhënien e projekteve të cilat KKRMs-së i implementoi me përkrahjen e tyre. Z-nja Mechthild Richert, gjithashtu kishte takim edhe me sekretarin e KK të qytetit të Shkupit dhe vizitoi Qendrën për përkrahjen e azil kërkuesve dhe Pikën për pastrehimorët të KK të qytetit të Shkupit.





### Vizita e kryetarit të Kryqit të Kuq të Hungarisë - Më 18

janar Kryqi i Kuq i RM-së u vizitua nga kryetari i KK të Hungarisë, z. Georg Habsburg/ gjatë vizitës së shkurtër kryetari i KK të Hungarisë u takua me kryetarin e KCRM-së D-r Millço Trajkov dhe me Sekretarin gjeneral Sait Saiti. Në bisedimet e zhvilluara u prezantua puna e KCRM-së, si dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit me KK të Hungarisë. Posaçërisht u këmbyen përvoja rreth mënyrës së financimit të të dy organizatave, si dhe aktivitetet në pjesën e informimit, ndihmës së parë dhe dhurimit të gjakut.

### Bashkëpunim intensiv me Kryqin e Kuq të Venecuelës

- Kryetari i KCRM-së, Millço Trajkov në ftesë të Mario Vilaroel, kryetar i KK të Venecuelës në periudhën 18 – 23 mars të vitit 2011 e vizitoi KK e Venecuelës. Gjatë vizitës u këmbyen informacione për punën dhe aktivitetet e dy shoqatave nacionale, struktura organizative dhe prioritetet e caktuara në punën e KCRM-së. Nga takimi u soll vendim të nxitet bashkëpunimi mes dy shoqatave në kuadër të lëvizjes me përkrahje reciproke dhe këmbim të informacioneve.

### Takim me Kryqin e Kuq të Serbisë - Në periudhën prej 06 deri më 08

qershor Kryqi i Kuq i RM-së u vizitua nga delegacioni dy anëtarësh i Kryqit të Kuq të Serbisë udhëhequr nga kryetari prof. D-r Dragan Radovanoviq. Delegacioni u pranua nga ana e d-r Millço Trajkov dhe sekretarit gjeneral Sait Saiti. Vizita dyditore e shoqatës nacionale kishte për qëllim përparimin e punës në programet e përbashkëta dhe zhvillimin e bashkëpunimit mes veti. Gjatë vizitës përfaqësuesit e KK të Serbisë e vizituan edhe organizatën komunale të Kryqit të Kuq Veles, dhe u pritën nga ana e kryetarit të komunës së Velesit, Goran Petrov. Delegacioni i KK të Serbisë e vizitoi edhe organizatën komunale të Kryqit të Kuq të Kavadarit.

### Përparimi i bashkëpunimit me Gjysmehënë e Kuqe të Turqisë - Delegacion prej tre anëtarësh të KCRM-së të udhëhequr nga sekretari gjeneral Sait Saiti

realizuan vizitë bilaterale në Gjysmehënë e Kuqe të Turqisë në periudhën prej 11 – 14 dhjetor të vitit 2011. qëllimi i vizitës ishte përforcimi i bashkëpunimit mes veti në më shumë fusha programore të dy shoqatave nacionale në vitin 2012. Gjatë vizitës u realizua takim me drejtorin e organizatës, z. Omer Tashli, me çka u analizuan aktivitetet e realizuara deri tani të të dy SHN si dhe aktivitete e mundshme të përbashkëta në vitin 2012. gjithashtu delegacioni e vizitoi qendrën operative për katastrofa të GJHN së Turqisë në Ankara. Gjatë qëndrimit delegacioni u shoqërua nga z. Hajetin Çetin i cili është anëtar i këshillit ekzekutiv i GJHN së Turqisë dhe njëkohësisht është edhe përgjegjës për bashkëpunim me SHN të Kryqit të Kuq të rajonit Ballkanik. Gjatë vizitës, gjithashtu u vizitua edhe organizata komunale e GJHK të Turqisë Konja me çka u këmbyen njohuri në bazë të përvojave të kësaj organizate e cila udhëheq me spital që është pronë e organizatës komunale. Gjatë vitit 2011 GJHK e Turqisë e përkrahu implementimin e programit Kryqi i Kuq në Aksion – Promovim i vlerave humane i cili u implementua në të gjithë shoqatën nacionale.



## NDËRTIMI I LIDHJEVE PARTNERORE – BASHKËPUNIM ME KORRIN DIPLOMATIK

**Vizitë e Ambasadorit të Republikës së Zvicrës** - Ambasadori i Republikës së Zvicrës Stefano L Lazaroto më 12 maj 2011 vizitoi Kryqin e Kuq të RM-së. Në këtë takim ambasadori pati rastin të njoftohet me punën dhe aktivitetet e KK dhe i paraqiti mundësitë e ambasadës së Zvicrës për përkrahjen e aktivitetëve të sektorit qytetar dhe KK në Maqedoni. Sekretari gjeneral Sait Saiti e shprehi kënaqësinë e tij nga bashkëpunimi i deritanishëm me ambasadën dhe Fondacionin Swisscor. Në kuadër të këtij bashkëpunimi në muajin qershor KK siguroi përkrahje për kampin rinor medicinal për fëmijë nga Maqedonia që u mbajt në Sent Galen, Zvicërr.

**Vizita e Ambasadorit të Republikës së Sllovenisë** - Ambasadori i Republikës së Sllovenisë Brajan Bergant më 19 maj 2011 realizoi vizitë zyrtare në KKRMS-së me qëllim thellimin e bashkëpunimit dhe iniciativave të reja për bashkëpunim dhe përkrahjen e shoqatës nacionale nga ana e Ambasadës së Republikës së Sllovenisë. Në takimin u prezantuan puna, aktivitetet, arritjet e KKRMS-së me theksimin e iniciativave dhe bashkëpunimet e zbatuara me sektorin korporativ, ambasadat, organizatat qeveritare dhe joqeveritare. Ambasadori i Republikës së Sllovenisë, Brajan Bergant në fjalimin e tij shprehi dëshirën për bashkëpunim më të afërt të KK të Sllovenisë dhe KK të Maqedonisë. Sekretari gjeneral i KKRMS-së duke potencuar mundësitë, kapacitetet dhe resurset e shoqatës nacionale, shprehi gatishmëri për bashkëpunim dhe përgjigje në nevojat dhe iniciativat e reja, të cilat do të dalin nga hapja e kompanive të reja sllovene në Maqedoni dhe ndjenja e tyre e zhvilluar për përgjegjësi sociale, potencuar nga ana e ambasadorit. Gjatë bisedës u potencua edhe bashkëpunimi i shkëlqyeshëm me organizatave qytetare të Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit dhe Lubjanës.

**Vizita e zëvendës Ambasadorit të Gjermanisë Walter Leuchs në Kryqin e Kuq të RM-së** - Zëvendës ambasadori i ambasadës së Gjermanisë në Maqedoni z. Walter Leuchs dhe sekretari i parë i ambasadës Katharina Nauman – Etiene më 22 qershor 2011 vizituan KKRMS-së. Në takimin punues realizuar me sekretarin gjeneral të KK Sait Saiti dhe udhëheqësin e sektorit për programe Sasho Taleski, përfaqësuesit e lartë të ambasadës kishin rastin të njoftohen me punën dhe aktivitetet e KK dhe mundësitë për përkrahjen e aktivitetëve dhe punën e përbashkët. Në kuadër të takimit zyrtar Sekretari gjeneral theksoi bashkëpunimit shumëvjeçar të KKRMS-së me Kryqin e Kuq të Gjermanisë dhe të gjithë përkrahjen e deritanishme në projektet individuale dhe aktivitetet programore.

**Marrëveshje për bashkëpunim me Ambasadën Franceze** - Në përputhshmëri me marrëveshjen e nënshkruar për bashkëpunim me Ambasadën franceze në janar 2011 filluan me implementim aktivite dedikuar për përmirësimin e kapaciteteve për gatishmëri dhe veprim në rast të katastrofave. Në kuadër të marrëveshjes, u formua ekip i përbashkët për përgjigje në rast të katastrofave të përbërë nga vullnetarë të KK të qytetit të Shkupit dhe Ambasadës franceze. Për këtë ekip KKRMS-së mbajti dy punëtori me temë: "Si të përgatitemi dhe mbrohemi në rast të katastrofave". Nga edukimi i hasur u organizua edhe trajnim në teren në muajin maj, me skenar të paramenduar tërmet, evakuim dhe strehim të qytetarëve, ku bartësi i trajnimit ishte ekipi i përbashkët me përkrahje logjistike të KKRMS-së.





## AKTIVITETE RINORE

Në periudhën e kaluar rinia u treguan si bartës të më shumë aktiviteteve në teren me çka vazhdimisht e theksojnë rëndësinë për mbindërtim të vazhdueshëm dhe zgjerim të kapaciteteve në punën rinore. Njëpërmjet kyçje në të gjitha veprimtaritë e funksionimit të KK si dhe në aktivitetet projektuese, dhe njëpërmjet përdorimit të metodës së edukimit moshatar rinia në të gjitha OKKK në mënyrë aktive vepruan edhe në vitin 2011 të kaluar. Në kuadër të programit për luftë kundër tregtisë me njerëz janë mbajtur gjithsej 53 punëtori në 15 OKKK ku morën pjesë 1 479 pjesëmarrës nga shkollat fillore dhe të mesme. Programi për preventivë nga HIV/SIDA dhe infeksionet bartëse njëpërmjet marrëdhënieve seksuale përfshiu gjithsej 68 punëtori në 10 OKKK ku morën pjesë 1 757 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Në vitin 2011 filloi edhe implementimi i projektit për preventivë nga dhuna mes të rinjve, me fokus të posaçëm në preventivë nga dhuna gjatë garave sportive. Në një iniciativë të përbashkët me Ministrinë për punë të brendshme, Federata e basketbollit të Maqedonisë dhe OJQ Rubikon, gjatë sezonit garues 2011/2012 filloi të realizojë fushatë për uljen e numrit të incidenteve gjatë garave të basketbollit dhe promovimin e tolerancës dhe simpatizimit sportiv.

Më 26 korrik 2011 delegacioni prej 6 anëtarëve të Rinisë së KKRМ-së Zyrën qendrore të Federatës Ndërkombëtare të shoqatave të KK dhe GJHK dhe zyrën qendrore të Komitetit Ndërkombëtar të KK, në Gjenevë, ku kishin mundësi të njoftohen në mënyrë më detale me ngjarjet aktuale dhe fushatat të cilat implementohen në Lëvizje. Theks i posaçëm gjatë vizitave u dha në prezantimin e Propozim dokumentit Politika rinore, ku në muajin dhjetor u miratua gjatë Konferencës ndërkombëtare në Gjenevë.

Me qëllim që ta vërtetojë kornizën zhvillimore dhe prioritetet strategjike të rinisë në periudhën pesëvjeçare që vijon, vitin e kaluar u miratua "Plani strategjik për të rinj të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë 2010 – 2015". Më 5 dhjetor, me rastin e ditës botërore të vullnetarizmit, KKRМ-së organizoi promovimin e strategjisë së re e cila u prezantua para 14 organizatave rinore, mes së cilave edhe Agjencisë shtetërore për rini dhe sport.

Të rinjtë janë bartës të një pjese të madhe të aktiviteteve të cilat realizohen në teren, prandaj aktivitetet e tyre janë pjesë integrale e rezultateve të arritura në të gjitha veprimtaritë të cilat janë të prezantuara në këtë dokument.

## QENDRA PËR TRAJNIM DHE EDUKIM

Njëra prej aktiviteteve të Qendrës për trajnim dhe edukim të KCRM-së është organizimi i aktiviteteve edukative. Nëpërmjet kësaj forme të aktiviteteve rritet numri i aktiviteteve dhe vullnetarëve në KCRM-së me çka rritet edhe imazhi i SHN. Në vitin 2011 nëpërmjet pjesëmarrjes në shkollat për vizatim të njëjtin e mbaruan 10 vizitues, përderisa kursin për mësimin e gjuhës angleze gjithashtu e mbaruan 10 vizitues. U realizuan edhe një seri e ligjëratave për të punësuarit në sektorin për logjistikë dhe shërbimin profesional të KCRM-së me çka u përpunuan materiale adekuatë edukative.

**Siguria e ujit** -Vazhdon zhvillimi i mëtejme i shërbimit për siguri në ujë të KCRM-së në kuadër të Qendrës për trajnim dhe edukim të KCRM-së me rritjen e numrit të shpëtimtarëve të edukuar qëllimi i së cilëve është shpëtimi i jetës së njerëzve. Në vitin 2011 u organizuan 5 kurse për shpëtimtarë në pishina, janë edukuar 35 shpëtimtarë për në pishina dhe akua parqe. Gjithashtu u organizuan edhe 2 kurse për shpëtimtarë në ujëra të hapura dhe u edukuan 57 shpëtimtarë, dhe gjithashtu u ndanë edhe 208 legjitimacione të reja për shpëtimtarët në ujë.

Me qëllim përforcimin e bashkëpunimit dhe kapaciteteve të programit në vizitë të shërbimit për siguri në ujë pranë KCRM-së ishte kryetari i shërbimit për siguri në ujë të Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe d-r Klaus Vilkins kryetari i Federatës ndërkombëtare për shpëtim me çka me ILSE u nënshkrua edhe franshiza për edukim të vlerësuesve për siguri në plazhe. Si aktivitet për përforcimin e kapaciteteve të OKKK me vendim të Këshillit ekzekutiv të KCRM-së u formuan dy Qendra për siguri në ujë në Shkup dhe Ohër.

**Siguri në mal** -Qëllimi i shpëtimtarëve në mal në kuadër të Qendrës për trajnim dhe edukim të KCRM-së është reagimi në kohë në aksionet për shpëtimin e jetës së njerëzve në situata të rrezikshme për jetë. Në vitin 2011 vazhduan orvatjet për rregullimin dhe formimin normativ të shërbimit për shpëtim në mal. Në kuadër të sigurisë në mal gjatë vitit 2011 është formuar grup punues i cili përgatiti elaborat për shërbimin për shpëtim në mal. Kryqi i Kuq i RM-së në bashkëpunim me Federatën e sporteve malore të Maqedonisë prezantuan arrijtet e deritanishme dhe aktivitetet e ardhshme, si dhe resurset materialo – teknike dhe njerëzore të këtij plani. Në marrëveshje me Organizatën ndërkombëtare për shpëtim në mal IKAR – CISA, organizatën tonë e vizituan përfaqësues të shërbimit për shpëtim të Serbisë me qëllim të vlerësimit të gjendja në RM-së në bazë të shpëtimin në mal.



# Qëllimi strategjik 1

## MBROJTJA E JETËS DHE MIRËQENIES NË NJERIUT DHE PËRFORCIMI I AKTIVITETEVE PËR PËRMIRËSIM PAS KATASTROFAR EDHE GJENDJEVE NË KRIZË

Aktivitetet e realizuara në vitin 2011 janë në pajtueshmëri me Planin strategjik 2020 të KCRM-së dhe kontribuuan në realizimin e orvatjeve globale në shtet në kuadër të aktiviteteve të agjencive të angazhuara për menaxhim me kriza dhe Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim.

Për realizimin e qëllimit të programit “Përgjigje e shpejtë dhe efektive në rast të katastrofave”, numri më i madhe i aktiviteteve ishin implementuar në nivel lokal, që kontribuoi të përforcohen kapacitetet e organizatave komunale të Kryqit të Kuq, dhe të përmirësohet bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale dhe subjektet të cilat janë pjesë e sistemit për menaxhim me kriza, siç janë Qendra për menaxhim me kriza (QMK) dhe Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim (DMSH) në nivel qendror dhe lokal.



## PËRGATITJE DHE VEPRIM GJATË KATASTROFAR DHE GJENDJEVE NË KRIZË

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, QMK dhe DMSH ishin organizatorë të më shumë trajnimeve ndërkombëtare simulative dedikuar për trajnim në situata të ndryshme në rast të katastrofave me qëllim që të përmirësohet komunikimi dhe koordinimi i planit vendor dhe ndërkombëtar. Në këto trajnime morën pjesë përfaqësues të KCRM-së, të cilët duke zgjedhur detyrat e parashtruara i prezantuan resurset materialo – teknike, të cilat ishin të pranuar dhe futura në propozim dokumentin “Procedura standarde operative për komunikim, koordinim dhe bashkëpunim mes subjekteve të sistemit për menaxhim me kriza në gjendjen e shpallur”.

Në organizim të Qendrës për menaxhim me kriza dhe Korpusit të SHBA, prej 27 deri më 29 prill 2011 në Shtëpinë e ARM-së në Shkup u mbajt punëtorja “Plani nacionale për përgjigje dhe proceduar standarde operative”. Përkaj gjithash në punëtorja përkaj përfaqësuesit të Kryqit të Kuq, morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve në Republikën e Maqedonisë të cilët në bashkëpunim me QMK janë bartës të përpunimit të procedurave operative për bashkëpunim, koordinim dhe komunikim në kontekst të implementimit të Qëllimit partneror NATO G-0029, menaxhim të situatave urgjente, duke kështu menaxhimin me efekte të sulmeve terroriste.

## SISTEMI YNË PËR MENAXHIM ME KATASTROFA

Në vitin 2011 është përgatitur kornizë e re strategjike për përgjigje dhe veprim gjatë katastrofave për vitin 2011 – 2015.

Në periudhën prej 11-13 qershor në Pepelishtë, në organizim të Ministrisë për mbrojtje u mbajt trajnimi ndërkombëtar ushtaro – mjekësor “Medkur” 2011 me qëllim mbajtjen e lidhjeve dhe veprimet të përbashkët në teren në kushte të katastrofës ku ka një numër të madh të civilëve të lënduar, ku Kryqi i Kuq i RM-së prezanton dy ekipe mjekësore.

OKKK Manastir dhe Vinicë, në vitin 2011, organizuan kampe verore për të rinj, të cilat u përkrahën nga shoqata nacionale me mjete logjistike për pajisjen e kampit, dhe mbajtën ligjërata për vetëmbrojtje dhe mbrojtje në rast të katastrofave, si dhe kamp – menaxhim.

Në organizim të Kryqit të Kuq të Austrisë dhe Bullgarisë, tre përfaqësues të KKRМ morën pjesë në punëtorinë për ujë, sanim dhe promovim të higjienës që u mbajt në Bullgari.

Për nevojat e Ministrisë për mbrojtje, në korrik 2011 u organizua kamp veror në f. Pepelisht, me pjesëmarrje të studentëve të akademive ushtarake nga vendet ballkanike, ku përfaqësuesit e KKRМ-së mbajtën prezantim për vendin dhe rolin e KK në rast të katastrofave.

**Shërbimi kërkim** - Sipas të dhënave statistikore të Shërbimit për kërkim të KKRМ-së, gjatë vitit të kaluar u filluan 6 raste për persona të zhdukur, prej të cilëve 5 kanë të bëjnë me persona të zhdukur si rezultat i migrameve ekonomike, ndërsa në një rast palët kishin nevojë për dokumente të cilat e vërtetojnë statusin e tyre të të burgosurve ushtarak gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjithashtu një përfaqësues i Shërbimit për kërkim të KKRМ-së mori pjesë në takimin e katërt rajonal të Shërbimeve për kërkim të shoqatave nacionale të rajonit. Takimi u mbajt prej 15 deri më 17.10.2011, në Sarajevë në Bosnje dhe Hercegovinë, ku u përpunuan përmbajtje në pajtueshmëri me qëllimet e Strategjisë për zbatimin e lidhjeve familjare të Lëvizjes 2008 – 2018.

**Aktivitetet për uljen e rreziqeve nga katastrofat** - Me vazhdimin e projektit “Aktivitetet për uljen e rreziqeve nga katastrofat”, që në mënyrë financiare u përkrah nga ana e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, u realizuan aktivitete në 3 mikrorajone (Prilep, Krushevë dhe M. Brod) që u drejtuan kah përmirësimi i kapaciteteve të organizatave komunale dhe pushteteve lokale. Nga aktivitetet e planifikuara të projektit u implementuan aktivitete për ngritjen e vetëdijes publike tek rinia e shkollave të mesme për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në rast të katastrofave dhe përpunim i planeve për evakuim dedikuar për institucionet arsimore, në bashkëpunim me Qendrën për menaxhim me kriza, Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.

**BE IPA Forum i Evropës Juglindore për adaptim në ndryshimet klimatike** - Kah fundi i vitit 2010 KKRМ-së filloi me implementimin e Projektit rajonal BE IPA – Forum i Evropës Juglindore për adaptim në ndryshimet klimatike, të koordinuara nga ana e Kryqit të Kuq të Austrisë. Qëllimi i projektit është avokativiteti dhe lotimi për institucionet relevante qeveritare, vlerësimi i mjerueshmërisë së popullatës dhe territorit në ndryshimet klimatike me rekomandim të masave të mundshme për adaptim. Në kuadër të këtij projekti u formua Rrjeti i 18 shoqatave qytetare – Rrjeti për përgjigje klimatike, të cilat u kyçën në fushatën për adaptim në ndryshimet klimatike.

Nëpërmjet fushatës u prezantuan mënyrat e mundshme për atë se si njerëzit të adaptohen në kushtet e reja me qëllim që më lehtë t’i mbijetojnë ndryshimet. Vet adaptimi në ndryshimet klimatike çon kah ulja e sëmundjeve, lëndimeve, invaliditetit dhe vuajtjes. Përveç ndikimit në popullatën e përgjithshme ky projekt ndikon edhe në institucionet relevante qeveritare me qëllim sjelljen e rregulloreve dhe politikave për adaptimin në ndryshimet klimatike në territorin e Republikës së Maqedonisë.



# Qëllimi strategjik 2

## PËRPARIMI I SHËNDETIT DHE JETËS SË SIGURT TË NJERËZVE

Kryqi i Kuq i RM-së në pajtueshmëri me Strategjinë 2020 dhe aktivitetet e rregullta programore vitin e kaluar implementoi aktivitete në teren me qëllim të mundësojë promovim të shëndetit si parakusht i rëndësishëm për realizim të tërësishëm të potencialit njerëzor, dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut.

Në kuadër të punës së vet, në këtë periudhë, u implementuan disa projekte të drejtuara kah grupet e mjeruara të qytetarëve me qëllim preventimin nga sëmundjet ngjitëse dhe kronike dhe uljen e dëmeve nga gjendje të caktuara shëndetësore. Në këtë drejtim të territorit të RM-së u zbatuan edukime nga ndihma e parë për organizata punuese dhe kandidatë për vozitës, edukime për sëmundjet e enëve të gjakut, tuberkulozit, sëmundjes së sheqerit, ushqimit të shëndoshë, sëmundjeve seksuale bartëse, higjienës, pasojave shëndetësore nga ndryshimet klimatike etj.

Gjithashtu KCRM-së në mënyrë tradicionale u kyç në shënimin ditëve dhe javëve botërore shëndetësore – preventive, p.sh. Java e luftës kundër sëmundjes së sheqerit, Java e luftës kundër kancerit, Java e luftës kundër sëmundjeve të zemrës dhe enëve të gjakut, Java e luftës kundër HIV/SIDA dhe Muaji i luftës kundër sëmundjeve të varshmërisë. Gjatë këtyre javëve KCRM-së zbatoi aktivitete në drejtim të ngritjes së vetëdijes publike për shkaqet të cilat nxitin komprometimin e shëndetit të njeriut.

Në kuadër të planifikimit të mirë strategjik KCRM-së përpunoi Plan strategjik për veprimtarinë shëndetësore – preventive 2011 – 2015, i cili i planifikon dispozitat në drejtim të shëndetit publik, si dhe ndihmë dhe përkrahje të grupit të mjeruar të qytetarëve në pesë vitet e ardhshme.



## NJERËZ TË SHËNDOSHË – BASHKËSI TË SHËNDOSHA

Në kuadër të hartimit të grupeve të mjeruara të qytetarëve KCRM-së filloi me implementimin e disa aktiviteteve të reja projektuese me të cilat punon në preventivën e sëmundjeve të caktuara kronike dhe akute.

### Promovimi i higjienës – Higjiena për shëndet të mirë

- Përkrahur në mënyrë financiare nga Kryqi i Kuq i Spanjës, projekti kishte për detyrë të zgjerojë diturinë për nevojat dhe pasojat e sëmundjeve të diarresë me qëllim ndalimin e bartjes fekale – orale të infeksioneve. Ky projekt u implementua në territorin e qytetit të Shkupit në mjediset rurale dhe urbane, përderisa grupi qëllimor ishin 1 900 fëmijë të 18 shkollave fillore dhe të mesme, vullnetarët e 2 klubeve për të rinj të KK, si dhe fëmijët dhe nënat Rome të ikur, pjesëtarë të Bashkësisë së të ikurve dhe kërkuesve të azilit. Gjatë këtij projekti janë përpunuar materiale për komunikim – postere, broshura dhe fletushka, gjithashtu secili i ri i pranishëm në trajnim mori paketë higjienike të përbërë nga kutia, brusha dhe pasta për dhëmbë, kuti me sapun, si dhe peshqir për duar. Në kuadër të këtij projekti 10 vullnetarë të rinj u hasën me dituri për “Promovim i Higjienës – Metoda dhe qasje participuese në promovimin e higjienës nëpërmjet kyçjes aktive të bashkësisë”, e gjithashtu trajnimin e njëjtë e morën edhe 18 profesorë të shkollave të hartuara.

## **Klubi 25 – motivues të rinj në dhurimin e gjakut**

-Prej majit të vitit 2011 KCRM-së filloi me implementimin e fazës së dytë të projektit “Klub 25” të përkrahur në mënyrë financiare nga Federata Ndërkombëtare e KK dhe GJHK. Qëllimi i projektit është mobilizimi i dhuruesve të rinj të gjakut, ndërtimi i kulturës të dhurimit të gjakut, preventiva shëndetësore dhe humaniteti. Nëpërmjet këtij projekti vetëm në vitin 2011 u mobilizuan 15 motivues të rinj në dhurimin e gjakut. Në kuadër të këtij projekti u organizua fushatë për mobilizimin e dhuruesve të rinj të gjakut, punëtori edukative nga fusha e HIV/SIDA, aksione për dhurimin e gjakut, si dhe seminar për motivues të rinj në dhurimin e gjakut ku morën pjesë 22 të rinj.

## **Klube për gjidhënie optimale për foshnje dhe fëmijët e vegjël**

- KCRM-së si një ndër grupet më të ndryshme qëllimore i njeht nënat gjidhëse, foshnjat dhe fëmijët e vegjël. Për këtë qëllim nëpërmjet aktiviteteve projektuese në territorin e Komunës së Ohrit u hapën klube të reja për edukim dhe këshillim të nënave për ushqyerje adekuat dhe të shëndoshë për lehonat dhe fëmijët e vegjël. Në kuadër të këtij projekti, të përkrahur në mënyrë financiare nga ana e Kryqit të Kuq të Austrisë, u zbatuan edukime për gjidhënie të rregullt për foshnjat, të ushqyerit optimal të fëmijëve të vegjël, si dhe të ushqyer të shëndoshë të fëmijëve parashkollor. Gjithashtu nënat morën këshilla nga personat mjekësor të angazhuar në projekt dhe patën mundësinë të këmbejnë përvoja me nënat tjera gjatë diskutimeve të hapura. Si rezultat i implementimit të projektit u edukuan 780 nëna në mbi 71 punëtori. Për nevojat e këtij projekti u përpunuan dy lloje të broshurave dhe postareve edukative të përkthyer në dy gjuhë maqedonishte dhe shqipe.

## **Mbajtje të prevalencës së ulët të HIV në RM-së**

- Projekti u implementua në tri OKKK Prilep, Veles dhe Kërçovë, dhe u përkrah në mënyrë financiare nga Fondi global për luftë kundër SIDA, tuberkulozë dhe malaria, nëpërmjet Ministrisë së shëndetësisë. Projekti ka për qëllim uljen e pasojave të dëmshme nga përdorimi i drogave: ulja e rrezikut nga HIV/SIDA, hepatiti B dhe C dhe infeksione tjera seksuale bartëse nëpërmjet gjakut, mbidozimi dhe pasoja tjera shëndetësore dhe dëme sociale. Në kuadër të projektit në vitin 2011 u realizuan 3 punëtori në nivel lokal për përfaqësuesit e qendrave shëndetësore dhe sociale, policia dhe vetëqeverisja lokale me qëllim uljen e diskriminimit drejt këtij grupi qëllimor.

Gjatë vitit në tre qendrat u distribuuan 21 299 gjilpëra dhe 11 672 injeksione, janë ndarë 7 300 prezervativë pa pagesë, janë dhënë 2 300 shërbime elementare mjekësore, këshilla dhe edukime për HIV/SIDA, hepatit dhe infeksione tjera seksuale bartëse nëpërmjet gjakut, këshilla për testim pa pagesë për HIV/SIDA, edukim për injektim të sigurt dhe marrëdhënie të sigurt seksuale për klientët dhe partnerët e tyre, këshilla për efektet e dëmshme nga përdorimi i drogave dhe informim për llojet e trajtimit, 1 666 shërbime sociale dhe 57 shërbime dhe këshilla juridike.

## **Përpunimi i planeve lokale strategjike dhe operative për përmirësimin e kontrollit me tuberkulozin në RM-së**

- Duke bashkëpunuar me përfaqësuesit e vetëqeverisjeve lokale KCRM-së është fasilitor në procesin e sjelljes së planeve të qëndrueshme dhe efikase strategjike operative për preventivë nga tuberkulozi në nivel lokal, që do të kontribuonte për uljen numrit të rasteve të reja me tuberkulozin, si dhe vdekshmërinë nga kjo sëmundje. Përkrahur në mënyrë financiare nga Fondi global për luftë kundër SIDA, tuberkulozit dhe malaris gjatë vitit 2011, projekti u implementua në tre komuna të reja: Dibër, Dellçevë dhe Kavadar. Në kuadër të projektit KCRM-së realizoi edhe ligjëratat edukative për tuberkulozë në disa qytete dhe atë: Prilep, Veles, Strumicë, Ohër, Kavadar, Shkup me çka u përfshinë rreth 1 700 pjesëtarë të popullatës së mjeruar.



## NDIHMJA E PARË – SHPËTON JETË

Realizimi i aktiviteteve edukative drejtuar kah ngritja e vetëdijes dhe diturisë të popullatës për dhënie të drejtë të ndihmës së parë u zhvillua në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë territorin e vendit. Në pajtueshmëri me nevojat e grupeve qëllimore në vitin 2011 KKRМ-së u angazhua kah përmirësimi i trajnimeve nëpërmjet futjes së përmbajtjeve të reja tematike të cilat ishin të rëndësishme për dëgjuesit. Për këtë si shembull janë kurset edukative nga ndihma e parë për vozitës, organizata punuese, persona të moshuar, fëmijë të moshës parashkollore, përdorues intervenoz të drogave etj.



Në vitin 2011 KKRМ-së nëpërmjet organizatave të veta komunale realizoi 800 kurse nga ndihma e parë për organizata punuese dhe kandidatë për vozitës gjegjësisht aftësoi 13 500 qytetarë për dhënie të ndihmës së parë në rast të aksidenteve rrugore dhe lëndimeve në vendin e punës. Prej tyre 12 000 persona kaluan trajnimin për ndihmë të parë për kandidatë për vozitës përdorues të 1 500 persona të ndërmarrjeve publike dhe private kaluan trajnimin nga ndihma e parë në vendin e punës. Në gjysmën e dytë të shtatorit në OKKK Kumanovë u mbajt gara shtetërore nga ndihma e parë ku morën pjesë 24 ekipe nga OKKK të ndryshme në të gjithë territorin. Ekipi fitues i garës, për këtë vit, ishte OKKK Çair, vendi i dytë i takoi OKKK Qendër, përdoruesi i tretë i takoi ekipit të OKKK Prilep. Nëpërmjet organizimit të garës u shënuar edhe Dita botërore e ndihmës së parë.

Sa i përket garave ndërkombëtare nga ndihma e parë në periudhën prej 15 – 18 shtator 2011 KKRМ-së mori pjesë në garën e 7-të nga Ndihma e Parë në kryeqytetet e vendeve të Evropës Juglindore që u mbajt në Bukuresht, Rumani ku ekipi i Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit e mori vendin e parë nëpërmjet ekipit të OKKK Karposh. Në vitin 2011 ekipi i ndihmës së parë i OKKK Kisella Vodë mori pjesë në Garën Evropiane nga ndihma e parë që u mbajt prej 14 deri më 18 shtator në Veneci – Itali. Më 20 nëntor KKRМ-së në bashkëpunim me Këshillin republikan për siguri në komunikacionin rrugor, Minsitrinë për punë të brendshme, QMK dhe organizata tjera qeveritare dhe joqeveritare, u kyç në shënimin e Ditës botërore për të përkujtuar viktimat e fatkeqësive rrugore. Për këtë qëllim KKRМ-së në sheshin Maqedoni vendosi shtandin e vet me materiale edukativo – informative, e gjithashtu zbatoi trajnim stimulativ me paraqitje reale dhe sanim të lëndimeve më të shpeshta në komunikacion.

Në nëntor KKRМ-së në bashkëpunim me institucionet relevante qeveritare dhe joqeveritare, ishte pjesë e trajnimit simulativ për kontrollimin e gatishmërisë të shërbimit për ndihmë të shpejtë mjekësore në Shtip gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme dhe në krizë.

Në kuadër të aktiviteteve për përparimin dhe përforcimin e kapaciteteve të programit për ndihmë të parë u mbajt Tryezë e rumbullakët për ndihmë të parë, me pjesëmarrjet më shumë institucioneve dhe ministrive, ku soll vendim të formohet Trup koordinues nga ndihma e parë që do të jetë i obliguar ta përcjellë problematikën nga ndihma e parë dhe reagon në parregullsitë e detektuar në këtë problematikë.

Në drejtim të mbindërtimit të vazhdueshëm të edukatorëve ekzistues dhe demonstratorëve nga ndihma e parë, si dhe edukim të kuadrove të reja për nevojat e OKKK nëpërmjet Qendrës për trajnim dhe edukim të KKRМ-së u organizuan 9 kurse freskuese nga ndihma e parë për edukatorë dhe demonstratorë nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës dhe organizata punuese, ku morën pjesë 162 persona. Gjithashtu u organizua edhe një seminar për edukatorë të rinj dhe demonstratorë nga ndihma e parë për kurset për vozitës dhe organizata punuese, ku morën pjesë 16 persona.



Me qëllim unifikimin dhe njohjen në punë u përgatitën legjitimacione të reja nga ndihma e parë, ndërsa në kuadër të bashkëpunimit me Fakultetin e Mjekësisë në Shkup vazhdimisht u mbajtën takime punuese konsultative me instruktorët nga ndihma e parë. KKRМ-së vazhdimisht qëndron të sigurojë mbindërtimin e kapaciteteve të të punësuarve, dhe për këtë u mbajt edhe edukimi nga ndihma e parë për sektorin për logjistikë dhe shërbimin profesional.

## DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT

Në vitin 2011 Kryqi i Kuq i RM-së dhe Instituti për mjekësi transfuziologjike të Republikës së Maqedonisë realizuan 55.737 njësi gjaku apo nga 55.000 njësitë e planifikuara të gjakut, realizuan 101.34%. Gjatë tërë vitit u mbajtën 57 mbledhje koordinatave ku u organizuan dhe realizuan 885 aksione për dhurimin e gjakut në teren, u planifikuan 32.243 njësi gjaku, dhe u realizuan 30.716 njësi gjaku apo 95.26% nga e planifikuara.

Në vitin 2011, 19 organizata komunale të KK e plotësuan planin për dhurimin e gjakut dhe atë: Manastir 105.54%, Vallandovë 118.13%, Veles 233.26%, Vinicë 304.45%, Demir Hisar 111.00%, Dibër 128.19%, Dellçevë 153.15%, Kavadar 131.62%, Koçan 112.00%, Kratovë 123.70%, Kriva Pallankë 123.49%, Krushevë 237.86%, Negotinë 101.99%, Ohër 141.85%, Prilep 101.54%, Probishtip 150.32%, Sh. Nikollë 175.25%, Shtip 269.71% dhe Qendër 201.28%. Rezultate më të dobëta në vitin 2011 në dhurimin e gjakut realizuan OKKK Gostivar me 38.97%, Tetova 39.97% dhe Radovish me 41.53%.

Në vitin që kaloi u mbajtën 4 seminare dhe edukime në kuadër të programit për dhurimin e gjakut dhe atë edukimi i motivuesve për dhurim vullnetar të gjakut me përfaqësuesit e pjesëtarëve shqiptar, turk dhe rom, ku u trajnuan 20 persona nga Shkupi dhe Kumanova. Gjatë muajit korrik u mbajt seminar edukativ për dhurimin e gjakut në organizim të Klubit të dhuruesve të gjakut të KK Uzhiçë dhe KK të Novi Sad-it. Në periudhën prej 01 – 04 shtator 2011 në Strugë u mbajt edhe seminar për edukim të motivuesve të rinj në dhurimin e gjakut për nevojat e OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit, përdërisa në organizim të KK të qytetit të Shkupit në periudhën prej 18 – 20 nëntor u organizua seminar për edukimin e 22 anëtarëve të rinj të Klubit 25 për dhurimin e gjakut në prani të ligjëruesve ndërkombëtar.

Gjithashtu, u shënuan edhe 17 marsi – Dita e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe 14 korrik Dita botërore e dhurimit të gjakut me çka u ndanë mirënjohje dhe shpërblime për organizatat më të suksesshme komunale të Kryqit të Kuq, për institucione dhe individë, me çka u realizuan dhe u promovuan aktivitete me rininë e Klubit 25.



## ULJA E PASOJAVE SHËNDETËSORE NGA NDRYSHIMET KLIMATIKE

Në bashkëpunim me Ministrinë e shëndetësisë dhe Organizatën Botërore Shëndetësore – zyra Shkup, KKRМ-së në pajtueshmëri me planin aksionar për valë të nxehta vazhdimisht ndërmerr aktivitete për mbrojtjen e shëndetit të popullatës, ngritje të vetëdijes publike për pasojat e mundshme, si dhe edukim për preventivë me qëllim mbrojtjen e shëndetit nga valët e nxehta.

Gjatë vitit 2011 u botuan 4 lloje të fletushkave në 120.000 shembuj me këshilla për mbrojtjen e shëndetit dedikuar për popullatën e përgjithshme, personat e moshuar, punëtorët dhe udhëheqësit e institucioneve shëndetësore dhe sociale të cilët nëpërmjet organizatave komunale të KK dhe Qendrave për shëndet publik u distribuuan në të gjithë territorin e vendit tonë.

Gjithashtu, u hap linja SOS pa pagesë për valë të nxehta në kuadër të KK të qytetit të Shkupit për informim masiv të vazhdueshëm të popullatës nëpërmjet mediave elektronike dhe të shtypit, distribuim pa pagesë të ujit në shishe, ligjëratë edukative për grupe të rrezikuara të popullatës, si dhe punëtorë, persona të moshuar, gra shtatzëna, matje të shtypjes së gjakut etj.

# Qëllimi strategjik 3

## PËRPARIMI I KYÇJES SOCIALE DHE KULTURA KUNDËR DHUNËS DHE PAQES

Për promovimin kundër dhunës dhe paqes, si dhe përparimin e kyçjes sociale, Kryqi i Kuq i RM-së punon në fushën e diseminimit të kulturës së dialogut, paqes dhe tolerancës nëpërmjet realizimit të programit për rekrutimin e vullnetarëve të rinj Kryqi i Kuq në Aksion – Promovimi i vlerave humane (KKA – PVH), programit për diseminim, si dhe veprimtarisë sociale – humanitare.

### PROMOVIM I ZBATIMIT PRAKTIK TË PARIMEVE THEMELORE



Dispozitat strategjike të programit për diseminim realizohen nëpërmjet përhapjes së diturive për Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, parimet themelore, emblema, E Drejta Ndërkombëtare Humanitare dhe vlerat humane, me përdorimin e programeve VDH dhe KKA – PVH, si model i posaçëm për diseminim.

Në periudhën dhjetor – mars të vitit 2011 u përpunua Plani i ri strategjik për diseminim 2011 – 2015 ku janë përfshirë dhe përpunuar aktivitetet e planifikuara për zhvillimin dhe përparimin e të gjitha pjesëve përbërëse të programit.

Në pajtueshmëri me nevojat e 14 OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit për përforcimin e kuadrit për zbatimin e sesioneve diseminative në pjesën e parë të vitit 2011 u mbajtën dy trajnime të diseminatorëve të rinj. Në kuadër të punëtorëve u trajnuan 11 diseminatorë të rinj për nevojat e OKKK në teritorin e qytetit të Shkupit dhe 10 diseminatorë nga OKKK tjera në Republikën e Maqedonisë.

Në periudhën prej 26 – 29 prill të vitit 2011 KKRМ-së ishte nikoqir i takimit rajonal për përparimin e programit “Vëzhgim i të drejtës humanitare” të organizuar nga ana e Komitetit Ndërkombëtar të KK, ku morën pjesë përfaqësues të shoqatave nacionale dhe ministrive për arsim të dymbëdhjetë vendeve nga rajoni dhe Evropa lindore, si dhe përfaqësues të KNKK.

Në kampin e pestë të programit “Vëzhgimi i të drejtës humanitare” i cili u mbajt në periudhën prej 15 – 18 shtator të vitit 2011 në Divçibar të Serbisë, KKRМ-së mori pjesë me tre përfaqësues. Në seminarin, përfaqësuesit e 12 vendeve e mësuan të drejtën ndërkombëtare humanitare, nëpërmjet lojërave interaktive dhe promovimit të mini programit VDH. Gjithashtu KKRМ-së në vitin 2011 ishte pjesë e pilot fazës së Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për testimin e modelit të ri të Mini VDH (Vëzhgimi i të drejtës humanitare), që u zbatua në dy faza nga ana e instruktorëve tanë internacional.

Komiteti nacional për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare (DNH) në vitin 2011 mbajti dy mbledhje në KKRМ-së, si sekretariat i trupit ndër resor. Në mbledhjen e dytë si mysafirë në mënyrë aktive morën pjesë përfaqësues të Komitetit Ndërkombëtar të KK nga Beogradi dhe Sarajeva. Në pajtueshmëri me dispozitat e rregullores për punë, Ministria e mbrojtjes së RM-së për kryetar të ri e caktoi Ministrinë e drejtësisë të RM-së, që dy vitet e ardhshme do ta koordinojë punën e Komitetit Nacional për DNH.

Në vitin 2011 përfaqësuesit e Fakultetit juridik – Shkup dhe Akademisë ushtarake “Gjeneral Mihajlo Apostollski” me përkrahjen e KKRМ-së dhe Komitetit Ndërkombëtar të KK morën pjesë në garat internacionale për DNH Mut Kort (Moot Court) të mbajtur në Sarajevë dhe Zhan Piktet (Jean – Pictet) në Francë.

## Kryqi i Kuq në Aksion – Promovimi i Vlerave Humane

- Gjatë vitit 2011 në programin KKA – PVH, të përkrahur në mënyrë financiare nga ana e Gjysmëhënës së kuqe të Turqisë u kyçën 1.053 të rinj dhe 35 diseminatorë nga të gjitha OKKK në RM-së. Në kuadër të programit u realizua punësoria përgatitore KKA – PVH ku u shqyrtuan dhe vlerësuan 115 projekte të vogla KKA – PVH për mirëqenien e bashkësisë të përpunuara nga ana e të rinjve të Kryqit të Kuq. Nëpërmjet mbajtjes së dy punësive finale KKA – PVH, në fillim të muajit maj dhe qershor të gjithë 89 të rinjtë dhe 18 diseminatorët, të cilët morën pjesë kaluan sesione për kulturën si sistem i vlerave, komunikim dhe teknika komunikatave dhe së bashku realizuan evaluimin e tërë ciklit të kaluar. Trofeu për OKKK më të suksesshme në kuadër të KKA – PVH këtë vit shkoi në OKKK Ohër.

Në ciklin e ri KKA – PVH i cili filloi në shtator të vitit 2011, me qëllim promovim më të madh të kulturës së dialogut në pajtueshmëri me Strategjinë 2020 të KKR-së, përparimit të kyçje sociale dhe kulturën kundër dhunës dhe paqes, u vërtetua nevoja e realizimit të trajnimeve të dyfishta, në gjuhën maqedonishte dhe shqipe në 9 OKKK.

Në vitin 2011 programi KKA – PVH u implementua edhe në 13 shkolla fillore në territorin e komunës Qendër dhe qytetit të Shkupit, të përkrahur në mënyrë financiare nga ana e komunës Qendër dhe Komitetit ndërkombëtar të KK. U përpunuan 30 projekte të vogla, 368 nxënës të edukuar, me të cilin u ndihmuan 294 grupe qëllimore me veshmbathje, ushqim, aparate për amvisëri, animacion, libra etj., përderisa 39 nxënës dhe 10 profesorë ishin pjesë e punësive finale KKA – PVH.

Si sukses i posaçëm për programin KKA – PVH është vendimi i Komunës Qendër në vitin 2011, shpërblimin e vet Feniks, ta ndajë me KK të qytetit të Shkupit për realizimin e më shumë aktiviteteve të rëndësishme në Klubin rinor, si dhe për implementimin e programit KKA – PVH në të gjitha shkollat fillore në territorin e komunës Qendër me çka u arritën rezultate të jashtëzakonshme.



## MUNDËSIMI I INTEGRIMIT MË TË MIRË TË NJERËZVE TË CILËT JANË GJETUR NË SITUATË TË PADËSHIRUESHME

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë vazhdimisht angazhohet dhe bën orvatje në mbrojtjen e dinjitetit dhe uljes së rrezikut të shfaqjes së grupeve të mjeruara qëllimore të popullatës. Nëpërmjet formave dhe metodave të reja për punë rriten mundësitë për përmirësimin e socializimit dhe integritit të njerëzve të cilët janë gjetur në situata të padëshirueshme.

Me qëllim që KKRM-së t'i prezantojë dispozitat afatgjate për veprim në bazë të uljes së mjerueshmërisë së popullatës, përgatiti Plan strategjik për veprimtari socialo – humanitare 2011 – 2015 me të cilin janë definuar drejtime për zhvillimin e aktiviteteve socialo – humanitare për kënaqjen e nevojave primare të popullatës së mjeruar në Maqedoni.

**ЦРВЕН КРСТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА**  
**KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Кампања за ДЕНОТ НА ГЛАДА | 16 Октомври  
Fushata për DITËN E URISË | Tetor

СО ПОВИК НА БРОЕВИТЕ  
МЕ THIRRJEN E NUMRAVE  
070/075/077  
**143-400**

ДОНИРАЈТЕ 100 ДЕНАРИ  
DHURONI 100 DENARË

**...ПОМИСЛЕТЕ И НА НАС...**  
**...MENDONI EDHE PËR NE...**

**“Kontributi juaj – ndihmë e rëndësishme”** - KKRM-së nën moton “Kontributi juaj – ndihmë e rëndësishme” prej 11 deri 17 prill 2011 me aktivitete e shënoi “Javën e solidaritetit”. Në kuadër të Javës, Kryqi i Kuq organizoi aksion grumbullues me qëllim që të ngrihet ndjenja e humanizmit, dhe solidaritetit tek qytetarët dhe të sigurohet ndihmë adekuate për kategoritë më të mjeruara të popullatës. Në aksionin u siguruan gjithsej 5.500 kg ushqim, 16.200 kg rroba dhe 1.100 mbathje. Gjatë kësaj jave u organizua edhe aksioni “Prej njëres shtëpi në shtëpi tjetër” ku vullnetarët e organizatave komunale të KK vizituan mbi 15.500 familje në shtëpitë e tyre, prej të cilëve 10.350 e përkrahën aksionin dhe dhuruan gjithsej 450.000 denarë. Mjetet financiare të grumbulluara nga aksioni organizatat komunale të KK i dedikuan për sigurimin e ndihmës në ushqim për popullatën e mjeruar dhe me aksionin u përfshinë gjithsej 1 500 persona të cilët kishin nevojë për ndihmë të këtyllë.

**Fushata për “Dita e urisë”** - Kryqi i Kuq i RM-së më 16 tetor – Ditën ndërkombëtare të urisë, e shënoi me më shumë aktivitete të cilat u organizuan gjatë fushatës nën moton “Mendoni edhe për ne”. Qëllimi i fushatës është ngritja e mendimit të përgjithshëm të opinionit për problemet e varfërisë, si dhe sigurim i mjeteve dhe resurseve të nevojshme për ndihmën e popullatës së mjeruar. Në kuadër të fushatës u organizuan aktivitete për sigurimin e artikujve ushqimor, grumbullimin e të hollave, aksione në bashkëpunim me shitoret, si dhe shumë aksione tjera të organizuara nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të KK në vend. Në aksion u siguruan gjithsej 535.245 denarë dedikuar për furnizimin e ushqimit. Janë grumbulluar dhe furnizuar gjithsej 8.137 kg ushqim dhe 12.000 kg veshmbathje. Një pjesë e kësaj ndihme është ndarë menjëherë për 1.468 persona. Përkrahje e aksionit për sigurimin e mjeteve nga sektori korporativ siguroi Posta e Maqedonisë SHA Shkup, e cila mundësoi pa pagesë të dërgohen 12.000 fletushka në kompanitë e vendit për përkrahjen e tyre në fushatë. Në aksion dhuruan gjithsej 53 kompani dhe nga mjetet e dhuruara në lartësi prej 116.340 denarë u siguruan gjithsej 180 paqeta me ushqim, të cilat organizatat komunale të KK i ndanë për nevojat e personave dhe familjeve të cilat ballafaqohen me rreziqe të caktuara sociale dhe kanë nevojë të tillë.

## “Secili person i moshuar ka të drejtë”

- Java tradicionale “Java e kujdesit për personat e moshuar” u shënuar prej 21 deri 27 nëntor në bashkëpunim dhe përkrahje të EVN Maqedoni nën moton: “Secili person i moshuar ka të drejtë”. Qëllimi i shënimit të javës është ngritja e vetëdijes së popullatës për të drejtat e personave të moshuar, si dhe kujdesi dhe ndihma e nevojshme të personave të moshuar. Në bashkëpunim me Entin për punë sociale dhe EVN Maqedoni u përgatit material promovues. Në kuadër të javës u organizua edhe aksioni për matje pa pagesë të sheqerit në gjak dhe matjen e shtypjes gjakut, për të cilin EVN Maqedoni siguroi lenta dhe gjilpëra për marrjen e gjakut, përderisa aparatet për matjen e nivelit të sheqerit në gjak për secilën OKKK janë dhuruar nga ana e kompanisë Adriamed. Në kuadër të shënimit të javës KK përfshiu gjithsej 4.386 persona të moshuar nëpërmjet aktiviteteve më të ndryshme, si matja e sheqerit në gjak dhe matja e shtypjes së gjakut, vizita e personave të moshuar, persona të vetmuar dhe të ligur në shtëpitë e tyre me kyçjen e vullnetarëve të rinj të KK dhe nëpunësit shëndetësor, vizita në shtëpitë për persona të moshuar, shtëpitë për pensionistë etj.

## Aktivitetet për përkrahjen dhe kujdesin e personave të moshuar

- Në vitin 2011 me përkrahjen e Kryqit të Kuq të Gjermanisë Baden Vitemberg vazhduan të implementohen aktivitetet e Klubit të pensionistëve nëpërmjet OKKK Kriva Pallankë, ku në mënyrë aktive marrin pjesë 40 pensionistë.

Në kuadër të aktiviteteve projektuese funksionin edhe ekipi mobilizues i vullnetarëve të cilët kryejnë vizitë dhe kujdes për personat e moshuar në shtëpitë e tyre. Në muajin qershor është bërë trajnim i ekipit për vlerësim të shpejtë dhe është rritur numri i personave të moshuar për ndihmë në shtëpitë e tyre nga ana e vullnetarëve të KK prej 10 deri më 30 persona të moshuar. Aktivitetet projektuese janë drejtuar kah kyçja e personave të moshuar në aktivitetet shoqërore të bashkësisë, si dhe sigurimi i ndihmës për grupet më të mjeruara të lagjeve fshatare. Qëllimi themelor është përmirësimi i kualitetit të jetës së personave të moshuar, nëpërmjet përmirësimit të gjendjes së tyre psiko – sociale, punëtorive edukative dhe kreative, shëndetit, si dhe ndihmë humanitare dhe kujdes shëndetësor për personat e moshuar të vetmuar dhe të ligur të mjediseve rurale.

Gjatë vitit u hap Klub edhe në OKKK Negotinë ku ka 20 anëtarë pensionistë.

Me përkrahjen e KK të Gjermanisë nëpërmjet OKKK Krushevë në muajin shtator 2011 filloi me implementim projekti për kujdesin e personave të moshuar në kushte shtëpiake. Në aktivitetet janë kyçur gjithsej 60 vullnetarë të KK prej të cilëve janë formuar 16 ekipe mobilizuese me të cilat janë përfshirë gjithsej 120 persona të moshuar.

## Kujdes për personat e moshuar në kushte shtëpiake

- Projekti filloi të realizohet gjatë muajit qershor 2011 me përkrahje financiare të Agjencisë austriake për zhvillim dhe të Kryqit të Kuq të Austrisë. Qëllimi i projektit është që të kontribuohet kah ndërtimi i kapaciteteve të KKRm-së në realizimin e aktiviteteve për përkrahjen e personave të moshuar, si dhe realizim i serviseve sociale dhe mjekësore dedikuar për këtë grup qëllimor. Projekti u implementua në KK të qytetit të Shkupit, OKKK Veles dhe Kriva Pallankë.

Në shtator të vitit 2011, nga ana e trajnuesve me përvojë të KK të Malit të Zi u realizuan dy seminare trajnuese për trajnimin e 60 vullnetarëve të kyçur në projekt, me qëllim përforcimin e kapaciteteve për realizim më të lehtë të shërbimeve sociale dedikuar për personat e moshuar të përfshirë në projekt. U realizuan edhe dy vizita studiuuese prej të cilave njëra në Mal të Zi dedikuar për trajnimin e 3 koordinatorëve lokal dhe përfaqësuesve të vetëqeverisjeve lokale, përderisa tjetra në muajin nëntor në Bullgari, dedikuar për trajnimin e gjashtë motrave medicinale me qëllim këmbimin e përvojave dhe diturive praktike me persona nga Bullgaria të angazhuar për implementimin e serviseve mjekësore dedikuar për personat e moshuar. Deri në fund të vitit 2011 me këtë projekt u përfshinë gjithsej 180 persona të moshuar nga Shkupi, Velesi dhe Kriva Pallanka.





## Zhvillimi i përbashkët i bashkësive

- Në shtator të vitit 2011 nëpërmjet OKKK Strugë me përkrahje të KK të Gjermanisë filloi realizimi i projektit “Zhvillim i përbashkët i resurseve” i cili u implementua në bashkësinë e mjeruar rrome në Komunën e Strugës. Në kuadër të përbajtjes projektuese prej 12 deri 14 tetor 2011, u mbajt trajnim i ekipit i cili i zbaton aktivitetet së bashku me anëtarët e bashkësisë. Më 29 nëntor 2011 u organizua punëtori me përfaqësuesit e anëtarëve të bashkësisë me qëllim që të prezantohen rezultatet e vlerësimit dhe analizës në teren, si dhe të vërtetohen nevojat primare të bashkësisë.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në partneritet të përbashkët me EVN Maqedoni prej 27 tetor 2011 filloi me implementimin e projektit “Zhvillim i përbashkët i bashkësive” që në periudhën një vjeçare do të realizohet nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, vetëqeverisjes lokale, vullnetarët e KK dhe përfaqësuesit e bashkësisë së mjeruar do të zbatohet cikli projektues i aktivitetëve në bashkësinë e mjeruar rrome në “Shuto Orizare” Shkup. Prej 12 -14 dhjetor u organizua trajnim i ekipit ku së bashku me anëtarët e bashkësisë së mjeruar rrome do të implementohen në bashkëpunim dhe përkrahje të EVN Maqedoni.

## Socializim më i mirë i fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme

- Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Entin për punë sociale tanimë tre vite radhazi implementojnë iniciativa të përbashkëta për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme. Banka Komerciale SHA Shkup ishte sponsor dhe partner i yni cili në mënyrë aktive u kyç në implementimin e aktivitetëve projektuese. Me dy punëtoritë informative që u mbajtën më 7 mars 2011 në KKRМ-së zyrtarisht u shënuar fillimi i projektit i cili u realizua deri në fund të vitit nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit me kyçje të pesë OKKK në Shkup, OKKK Prilep, Kavadar, Veles, Resnje, Kërçovë, Koçan dhe Dibër. Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Entin për punë sociale organizoi punëtori prej 31 mars deri më 2 prill në Strugë, me qëllim që të fitohen dituri dhe aftësi të caktuara për qasjen dhe përkrahjen e fëmijëve të rinjve me nevoja të posaçme. Aktivitetet që vijojnë dhe shumë të tjera ishin pjesë e aktivitetëve të implementuara në nivel lokal: vizitë e shtëpive të familjeve strehimore nga ana e ekipeve mobilizueset përbërë nga vullnetarët e KK, punëtori kreative, organizim të aktivitetëve rekreative, edukime për fëmijë, prindërit dhe fëmijët e strehuar, përkrahje psikologjike për fëmijë dhe prindër etj. KKRМ-së më 15.12.2011 organizoi punëtori për evaluim të aktivitetëve projektuese ku u vërtetuan rezultatet e arritura, efektet e aktivitetëve të implementuara, si dhe u dhanë udhëzime për veprim të ardhshëm në nivel lokal.

## Lufta kundër tregtisë me njerëz

- Aktivitetet për preventivë të tregtisë me njerëz në vitin 2011 u implementua nëpërmjet OKKK Manastir, Resnje, Gjevgjeli, Kavadar, Ohër, Tetovë, si dhe KK të qytetit të Shkupit me pesë OK karposh, Kisella Vodë, Qendër, Çair dhe Gazi Babë. Me përkrahje të KK të Gjermanisë në këtë program janë kyçur edhe tre OKKK Shtip, Gostivar, Kumanovë.

Në periudhën 30.08. – 05.09.2011 në bashkëpunim me OJQ Rubikon dhe ekspert të angazhuar është organizuar trajnim për 15 edukatorë të rinj për edukimin e rinisë për preventivë nga tregtia me njerëz dhe organizim të punëtorive forum teatër. Nëpërmjet edukatorëve moshatar në 8 qytete janë organizuar gjithsej 48 punëtori edukative ku morën pjesë 1 189 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Në punëtoritë janë distribuuar edhe materiale edukative. Me rastin e Ditës ndërkombëtare për luftë kundër tregtisë me njerëz 18 Tetori janë organizuar më shumë ekspozita kreative dhe anketa në më shumë qytete.

Me rastin e “Java e luftës kundër tregtisë me njerëz” 02 – 09 dhjetor në mënyrë më intensive janë organizuar punëtori edukative me të rinj të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe dy tribuna në bashkëpunim me

vetëqeverisjen lokale në Kavadar dhe Shkup.

Në bashkëpunim me H.E.R.A nëpërmjet OKKK Gostivar, Shtip dhe Kumanovë janë realizuar 5 edukime të bazuara në shfaqjen teatrale dhe projektim të filmit edukativ “Dy vajza” me përfshirje të rreth 300 nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme.

Në kuadër të mbindërtimit të kapaciteteve personale KCRM-së gjatë periudhës prej 30.08 – 01.09.2011 në Trogir, Republika e Kroacisë me përfaqësues të vet mori pjesë në mbledhjen rajonale të Rrjetit evropian të shoqatave të KK dhe GJHK për luftë kundër tregtisë me njerëz.

## Preventivë nga keqpërdorimi seksual i fëmijëve dhe pedofilisë

- Kryqi i Kuq i RM-së gjatë vitit 2011 në bashkëpunim me Entin për punë sociale u kyç në fushatën “Me edukim dhe dituri në preventivë nga keqpërdorimi seksual / pedofilia” që u realizua nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale. Prej 01 deri më 03 nëntor të vitit 2011 u mbajtën 3 punëtori informative me përfaqësues të KK të qytetit të Shkupit dhe pesë OKKK në Shkup, 23 OKKK, si dhe përfaqësues të qendrave për punë sociale. Në punëtoritë u prezantuan qëllimet e fushatës për sensibilizimin dhe ngritjen e vetëdijes publike për problemin e keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofilia. Gjatë fushatës u përfshinë gjithsej 142 shkolla të vendit. Në kuadër të fushatës u mbajtën takime me kuadrin profesional dhe prindërit e fëmijëve nga shkollat me qëllim që të informohen se si të ballafaqohen me problemin e keqpërdorimit seksual të fëmijëve dhe pedofilia.

## “Dita e vullnetarizmit”

- Kryqi i Kuq i RM-së në bashkëpunim me ALFA Banka SHA Shkup në muajin maj organizuan aktivitete të përbashkëta me qëllim që të implementohen iniciativa humanitare në kuadër të planit të përgjegjësisë korporative shoqërore të kompanisë për kënaqjen e nevojave të grupeve qëllimore. Me rastin e 29 maj-it – Dita e vullnetarizmit të cilën e promovonte ALFA Banka SHA Shkup, nga ana e bankës u dhuruan 100 paqeta familjare me ushqim dedikuar për grupet e mjeruara qëllimore të popullatës në 14 komuna të vendit. Përfaqësues të OKKK së bashku me përfaqësuesit e ekspoziturave të bankës, në ditën e shënimit të 29 majit bënë shpërndarjen e ndihmës duke përfshirë 100 familje të rrezikuara sociale.



## “Ta ndajmë lumturinë”

- Kryqi i Kuq i RM-së në bashkëpunim dhe përkrahje të EVN Maqedoni SHA me rastin e Festave të vitit të ri organizoi aksion humanitar nën moton “Ta ndajmë lumturinë”. Qëllimi i këtij aksioni ishte t’iu dhurohet buzëqeshje dhe lumturi fëmijëve të familjeve të rrezikuara sociale dhe fëmijëve me nevoja të posaçme dhe të ndahen momentet e lumtura për festat e vitit të ri. Me këtë aksion u siguruan 600 paqeta të vitit të ri dhuratë nga EVN Maqedoni që në periudhën prej 26 deri më 30 dhjetor të vitit 2011 u implementua nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit dhe OKKK Manastir, Prilep, Gostivar, Veles, Kavadar dhe Koçan. Në manifestimet e vitit të ri të organizuara për ndarjen e dhuratave për fëmijët u kyçën edhe të punësuarit e EVN Maqedoni.

**“Ta kthejmë buzëqeshjen në fytyrat e tyre dhe shpresën në sytë e tyre”** - Kryqi i Kuq i RM-së, Banka e Ohrit dhe Shoqata për fibrozë cistike me qëllim që të kontribuojnë në sigurimin e kualitetit më të mirë për jetën e fëmijëve të sëmurë nga fibroza cistike, në muajin qershor 2011 nën moton “Ta kthejmë buzëqeshjen në fytyrat e tyre dhe shpresën në sytë e tyre” organizuan aksion humanitar. Gjegjësisht, për të gjitha transaksionet e terminaleve të Bankës së Ohrit realizuar gjatë javës së solidaritetit, Banka ndau 0.5% nga vlera e transaksioneve dhe ato mjete i dhuroi për furnizimin e dy inhallatorëve për fëmijët me fibrozë cistike të Klinikës për sëmundje të fëmijëve në Shkup, të cilat i dorëzuan për nevojat e Shoqatës për fibrozë cistike.

**“Të kursejmë së bashku”** -Me rastin e 31 dhjetorit Dita ndërkombëtare e të kursyerit nën moton: “Të kursejmë së bashku” më 30 tetor 2011 në organizim të përbashkët të Stopanska Bankës SHA Shkup dhe Kryqit të Kuq të RM-së u realizua aksion humanitar ku të punësuarit e Bankës dhuruan veshmbathje të përdorur, lojëra, mbulesa. Aksioni u organizua në ekspozitat e Bankës në të gjithë Republikën në partneritet me 25 OKKK, si dhe KK të qytetit të Shkupit. Aksioni u realizua me sukses dhe u grumbulluan gjithsej 5 ton dhe 365 kg rroba të përdorura, 307 palë mbathje, 184 lojëra, 5 pajisje për kuzhinë, 38 materiale higjienike dhe një dyshek. Ndiha iu dorëzua KK për popullatën e mjeruar e cila ka nevojë për ndihmën e tillë.

**Dhurata për vitin e ri** - Me rastin e shënimit të 67 vjetorit të ekzistimit të Stopanska bankës SHA Shkup, banka përgatiti dhurata në veshmbathje, si dhe paqeta për vitin e ri për 40 fëmijë nga Qendra për përkrahjen e fëmijëve të azilkërkuesve në RM-së dhe në Qendrën ditore për strehimin e fëmijëve nga rruga. Me këtë rast KK i qytetit të Shkupit më 29 dhjetor të vitit 2011 organizoi ngjarje për ndarjen e dhuratave në qendrën në Shuto Orizare ku morën pjesë përfaqësues të Stopanska Bankës SHA Shkup dhe Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.



## Kampi mjekësor për fëmijët me nevoja të posaçme në Zvicër

- Në periudhën 18.07 – 01.08.2011 në Mels – Zvicër në organizim të Fondacionit Sviskor, me përkrahjen e KK të Maqedonisë dhe të Zvicrës, u mbajt kampi rinor mjekësor ku morën pjesë gjithsej 77 fëmijë nga Maqedonia në moshë prej 8 deri 18 vjet të cilët kanë probleme sociale dhe trupore të institucioneve: Shkolla për persona me shikim të dëmtuar “Dimitar Vllahov”, OJQ “Polio Plus”, Enti për rehabilitim Banja Banjsko, Shtëpia për fëmijë pa prindër “11 tetori”, Shtëpia për fëmijë pa kujdes prindëror dhe fëmijë të lëshuar “25 Maj” dhe fëmijë të strehuar në familje strehimore. Gjatë kohës së kampit fëmijët kaluan kontrollime mjekësore me çka janë bërë intervenime në dhëmbë në mbi 30 fëmijë, janë dhuruar 6 karroca invalidore, 14 syza, një protezë për kofsha, si dhe ndihmë tjera specifike për personat me hendikep fizik, është caktuar operacion në Maqedoni përkrahur nga Sviskor dhe janë bërë intervenime tjera më të vogla. Nga ana e vullnetarëve të KK janë organizuar punëtori edukative me temë promovimi i higjienës, të ushqyerit e shëndoshë dhe preventiva nga tregtia me njerëz.



## Bashkëpunim i vazhdueshëm dhe përkrahje e Kryqit të Kuq të Baden Virtemberg

- Gjatë vitit u siguroa përkrahje nga ana e KK të Gjermanisë të Baden Virtemberg i cili dymbëdhjetë vite me radhë vazhdimisht realizon bashkëpunim me KKRM-së. Ndihma humanitare përbëhej prej krevateve spitalor, karrocave për invalidë, rrotatorë, pajisje veshmbathje të re dhe dhurata tjera në vlerë të përgjithshme prej 110.910 euro. Ndihma u distribuua për nevojat e institucioneve shëndetësore dhe sociale në vend, si dhe për të ndihmuar popullatën e mjeruar.

Bashkëpunimi u përforcua edhe me përkrahjen e dy projekteve të KK, prej të cilave njëri u implementua nëpërmjet OKKK Kriva Pal-lankë – Klubi i pensionistëve dhe funksionimi i ekipeve për mobilizim për ndihmë dhe kujdes të personave të moshuar në kushte shtëpiake dhe projekti – kyçja e popullatës së re romë në procesin e arsimimit të realizuar nëpërmjet OKKK Negotinë.

Përfaqësuesi i KK të Baden Virtemberg z. Hans Miler gjatë vizitës në KKRM-së më 26 dhe 27 korrik 2011 e theksoi kënaqësinë nga aktivitetet projektuese të implementuara, si dhe mundësitë për përkrahjen e aktiviteteve të ardhshme të shoqatës nacionale.



# ORGANIZATA KOMUNALE TË KRYQIT TË KUQ TË CILAT FUNKSIONOJNË MIRË

## OKKK BEROVË

**Dhurata për vitin e ri për fëmijët me nevoja të posaçme** - Me rastin e festave të vitit të ri vullnetarët e OKKK Berovë organizuan festimin e vitit të ri për fëmijët me nevoja të posaçme në Qendrën ditore. U bënë 20 paqeta dhe kartolina të vitit të ri për fëmijë. Gjithashtu, u organizua edhe aheng nga ana e vullnetarëve të gjimnazit "Aco Rusovski", e njëkohësisht u përgatit dramë "Baba dimri dhe fëmijët e tij" që kishte sukses të madh.

## OKKK MANASTIR

**Kampi ndërkombëtar rinor Magarevo – Pelister** - Me qëllim trajnimin e rinisë për ndërtimin e kamp – lagjes për pranimin e të lënduarve dhe të ikurve gjatë fatkeqësive elementare, katastrofave dhe në rast lufte, OKKK Manastir organizoi Kamp ndërkombëtar rinor "Magarevo – Pelister" që u mbajt prej 22 deri më 26 korrik në oborrin e manastirit "Sh Dimitri" në fshatin Magarevë. Në kampin morën pjesë rreth 60 pjesëmarrës nga OKKK e vëllazëruara dhe Gjysmëhënës së Kuqe të Turqisë, Rumanisë dhe Serbisë, si dhe të rinjtë e OKKK Ohër, Vinicë, Karposh, KK të qytetit të Shkupit dhe gjithsesi qyteti nikoqir Manastiri.



## OKKK VALLANDOVË

**Pranim solemn i nxënësve të klasës së parë** - Organizata komunale e KK Vallandovë më 6 nëntor me rastin e lirim të komunës Vallandovë në Objektiv sportiv organizoi Pranim solemn të 170 nxënësve të klasës së parë. Pranimi u përcoll me program të pasur kulturor – argëtues të organizuar nga nxënësit dhe anëtarët e klubit të të rinjve. Gjithashtu morën pjesë një numër i madh i qytetarëve, vullnetarë dhe nxënës, ndërsa vet manifestimi paraqet pjesën përbërëse të programit të vetëqeverisjes lokale me rastin e shënimit patronatit.

## OKKK VELES

**Kampi veror – Papradishte** - Prej 17 deri më 19 korrik në shtëpinë malore në fshatin Papradishte u mbajt kampi tradicional veror për anëtarët e rinj të Klubit të të rinjve dhe pjesëmarrësve në ciklin KKA – PVH 2010 / 2011. Qëllimi i kampit ishte rritja e numrit të vullnetarëve në KK dhe kyçja e tyre në lëmi të ndryshme të veprimit të organizatës komunale.

## OKKK VINICË

**Shembull për humanizëm** - OKKK Vinicë tre dekada me radhë është në majë të më të mirëve në realizimin e dhurimit të gjakut në Maqedoni, që paraqet shembull për humanizëm. Çdo vit OKKK Vinicë planin për dhurim të gjakut e realizon me rreth 30%, ku në vitin 2011 planin për dhurimin e gjakut në mënyrë tradicionale është tejkaluar me 304,45%.

## OKKK GJEVGJELI

**"Marshi i humanitetit"** - Me rastin e Ditës botërore të KK 8 maji, Klubi i të rinjve të OKKK Gjevgjeli, me fillim në ora 12 organizoi "Marshin e humanitetit" gjegjësisht paradë prej 100 vullnetarëve nën moton "Gjeje vullnetarin në vete". Gjatë paradës vullnetarët iu shpërndanin kalimtarëve fletushka informative dhe bexhe. Paradës vullnetare iu bashkëngjiti edhe kryetari i komunës së Gjevgjelisë, me çka iu dha përkrahje vullnetarëve të rinj të Kryqit të Kuq.

## OKKK GOSTIVAR

**"Nata e shtrigave"** Klubi i të rinjve të OKKK Gostivar dy vite me radhë organizojnë aheng humanitar në formë të maskenballit "Nata e shtrigave". Rinia nga nacionalitetet e ndryshme përkaj shoqërimin dhe argëtimin grumbulluan edhe mjete financiare nëpërmjet shitjes së buletave, ndërsa mjetet e grumbulluara u përdorën për blerjen e artikujve ushqimor dhe mjeteve higjienike të cilat iu janë dhuruar 20 fëmijëve pa prindër.

### OKKK DEMIR HISAR

**“Keqkuptime gjimnaziste të dashurisë”** - Anëtarët e Klubit të të rinjve të OKKK Demir Hisar përgatitën shfaqje me temë: “Keqkuptime gjimnaziste të dashurisë” me qëllim ndihmën dhe përkrahjen e familjeve sociale më të rrezikuara në komunë. Nëpërmjet shfaqjes që u mbajt në shkollën e mesme komunale “Kërste Petkov Misirkov” u shitën 340 karta dhe me grumbullimin e mjeteve u siguruan prodhime ushqimore të cilat u dorëzuan në shtëpitë e tyre.

### OKKK DIBËR

**Dita botërore e fëmijëve me hendikep** - Për herë të parë nga themelimi i Qendrës Ditore për fëmijë me nevoja të posaçme më 3 dhjetor u shënua “Dita botërore e fëmijëve me hendikep” ku morën pjesë edhe rinia e OKKK Dibër. Grup qëllimor ishin fëmijët e kësaj qendre për të cilën u organizuan aktivitete të ndryshme kulturore – artistike ku morën pjesë institucione relevante, si dhe mediat lokale të cilat lanë shembull pozitiv për solidaritet dhe humanizëm.

### OKKK DELLÇEVË

**Aksion humanitar për grumbullim** - Më 30.10.2011 OKKK Dellçevë së bashku me Stopanska Bankën ekspoziturën Dellçevë, realizuan aksion të suksesshëm humanitar për grumbullimin e veshmbathjeve, lojërave etj. Gjatë aksionit u grumbulluan gjithsej 100 kg roba, 20 palë mbathje, lojëra dhe pajisje për ushqim. Ndihma u dedikua grupit të mjeruar të popullatës nga Dellçeva dhe Makedonska Kamenica të cilët kanë nevojë.

### OKKK KAVADAR

**18 tetori – Dita Evropiane për luftë kundër tregtisë me njerëz** - 20 vullnetarë të rinj nga OKKK Kavadar me rastin e 18 Tetorit - Dita Evropiane për luftë kundër tregtisë me njerëz organizuan aktivitete në sheshin e Kavadarit. njëra prej aktiviteteve më të rëndësishme ishte vendosja e kukullave në sheshin e qytetit dhe vitrinat e butiqeve të cilat ishin të veshura me rroba nga gazetat dhe të lidhura me shirit të verdhë në trup dhe shirit të kuq në buzë, që simbolizonin viktimat e tregtisë me njerëz. Ngjarje e cila tërhoqi vëmendje të madhe, për të cilën përkrahje dhanë vetëqeverisja lokale, policia dhe mediumet lokale.

### OKKK KËRÇOVË

**“Nxitja e kreativitetit tek fëmijët me nevoja të posaçme”** - Klubi i të rinjve të KK Kërçovë së bashku me mbrojtësit e Qendrës dhe prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme realizuan aktivitete të shkëlqyeshëm- përpunimin e stolive, e cila ishte pjesë e projektit “Përmirësim i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme”, financiar nga ana e Bankës komerciale SHA Shkup. Fëmijët me nevoja të posaçme së bashku me vullnetarët e KK kaluan një kohë të shkëlqyeshme ku përpunuan stoli të shkëlqyeshëm.



### OKKK KOÇAN

**Mbindërtimi i kapaciteteve** - Organizata komunale e KK Koçan me qëllim përforcimin e kapaciteteve të veta dhe resurset njerëzore në periudhën prej 23 – 29 maj 2011 fitoi edukator moshatar për preventivë nga alkoolizmi i cili u dërgua në seminar ndërkombëtar edukativ në Linjano – Itali. Pas kthimit në Koçan edukatori mbajti punëtori të reja për edukim moshatar me temë alkoolizmi dhe rinia ku 14 vullnetarë u hasën me dituri për keqpërdorimin e alkoolit tek rinia.

### OKKK KRATOVË

**Etno panairi** - Në shenjë respekti të festës së patronatit “Sh. Gjorgji Kratovski” u organizuan tre punëtori ku u përpunuan mbi 200 copë suvenirë autentike nga druri, tekstili, qeramika dhe materiali riciklues nga ana e Klubit të të rinjve pranë OKKK Kratovë. Këto punime dore u ekspozuan në Panairin e parë etno në qytetin e Krytovës. Mjetet e grumbulluara ia dhuruan bashkëqytetarit të vet të ri Vlladisllav Andreevski për shërim në Shkup.

### OKKK KRIVA PALLANKË

**Kujdes për personat e moshuar në kushte shtëpiake** - Organizata komunale e KK Kriva Pallankë nëpërmjet implementimit të projektit "Kujdes për personat e moshuar" në vitin 2012 në mënyrë aktive ndihmoi 60 persona të moshuar nëpërmjet sigurimit të ndihmës mjekësore dhe psiko – sociale për përdoruesit, si dhe sigurim të dhurimeve mujore me ushqim dhe barëra. Gjatë implementimit të projektit OKKK Kriva Pallankë fitoi 15 vullnetarë të cilët u kyçën në ekipet vullnetare.

### OKKK KRUSHEVË

**Unë sapo shpëtova jetë, po ju?** - Klubi i të rinjve të OKKK Krushevë, në bashkëpunim me Fondacionin ndërkombëtar Toshe Proeski dhe Institutin për mjekësinë e punës – Shkup, më 15 dhe 16 dhjetor organizoi Aksion memorial për dhurimin e gjakut në nder të Toshe Proeskit. Aksioni u realizua nën moton e Toshes për dhurimin e gjakut "Unë sapo shpëtova jetë, po ju?" ku dhuruan gjak 126 të rinj, të cilët e treguan humanitetin e tyre në nder të Toshe Proeskit.

### OKKK KUMANOVË

**Nikoqirë të Garës shtetërore nga ndihma e parë** - Në vitin 2011 OKKK Kumanovë kishte nderin të jetë nikoqir i Garës së 20-të jubilarë shtetërore nga ndihma e parë. Në garë morën pjesë 23 OKKK të RM-së dhe një ekip revyal nga OKKK Kisella Vodë nga Shkupi. Vendin e parë e mori OKKK Çair, përderisa nga fusha e diseminimit vendi i parë i takoi OKKK Kumanovë.



### OKKK MAKEDOSNI BROT

**Zgjatja dorën shokut tënd** - Vullnetarët e rinj të OKKK makedonski Brod morën njoftime nga moshatarët e tyre se në SH.F. "Kliment Ohridski" mësojnë 10 nxënës të prindërve vetmbajtëse – familjeve të rrezikuara sociale të cilët nuk kanë mundësi që vet ta paguajnë uniformën shkollore. Të nxitur nga kjo në festën fetare "Golema Bogorodica", organizuan aheng në klubin "Kardinal" në Makedonski Brod nën moton "Zgjatja dorën shokut tënd". Nga buletat për hyrje dhe donacionet patën sukses të grumbullojnë mjete që në tërësi ishin të siguruar për uniformat shkollore.

### OKKK NEGOTINË

**Secili person i moshuar ka të drejtë** - Në vitin 2011 OKKK Negotinë me sukses e shënoi Javën për kujdesin e personave të moshuar nën moton "Secili person i moshuar ka të drejtë", ku u përgatit programi për realizimin e aktiviteteve të caktuara në bashkëpunim me shoqatat dhe organizatat e ndryshme. Gjatë shënimit u realizuan matje pa pagesë të sheqerit në gjak, vizita e personave të moshuar, konkurse të artit figurativ në shkollë, si dhe turnir ndërmjet gjeneratave në shah ku morën pjesë anëtar[ t] klubit rinor dhe anëtarë të klubit të pensionistëve.

### OKKK OHËR

**Anija për shpëtim lundron nëpër liqenin e Ohrit** - Në kuadër të përforsimit të kapaciteteve të Qebdrës për Siguri në Ujë, OKKK Ohër zyrtarisht e futi në përdorim anijen për shpëtim të shërbyer nga ekupe për shpëtim dhe mjekësore dhe kapiteni. Qëllimi është që të kontribuohet në rritjen e sigurisë së notuesve dhe pjesëmarrësve në komunikacionin ujor, për shkak se mundëson transport të shpejtë dhe efikas të të lënduarve deri në entet adekuate mjekësore.



## OKKK PRILEP

**Përmirësimi i bashkëpunimit mes institucioneve** - OKKK Prilep, më 25 maj të vitit 2011 ishte facilitatori kryesor i punëtorisë rajonale "Përmirësimi i bashkëpunimit mes institucioneve në komunat Prilep, Manastir, Kavadar dhe Gjevgjeli të kyçur në procesin e menaxhimit të pacientëve me Hepatit C". Në punëtori morën pjesë edhe qendrat për uljen e dëmeve nga përdorimi i drogës, persona të cilët përdorin drogë, si dhe qytetarë të interesuar nga komunat e lartpërmendura.

## OKKK PROBISHTIP

**Aktivitetet të përbashkëta me Shoqatën "Pensionistë të lumtur"** - Në kuadër të Javës për përkujdesje të personave të moshuar u realizuan sesione edukative me tema adekuate nga ana e vullnetarëve – mjekë specialistë, matje të sheqerit në gjak dhe shtypjes së gjakut, si dhe këshilla mjekësore të 80 personave të moshuar. Në kuadër të Javës u mbajt gara tradicionale në lojëra shoqërore (shah, pikado, biliard) mes Klubit rinor të KK Probishtip dhe Klubit të pensionistëve, si dhe u realizua aksion grumbullues të veshmbathjeve të vjetra të cilat u shpërndanë në 15 familje të rrezikuara sociale të kësaj komune.

## OKKK RADOVISH

**Java e kujdesit për personat e moshuar** - Organizata komunale e KK Radovish në bashkëpunim me Shtëpinë shëndetësore dhe Shoqatën e pensionistëve nga Radovishi e shënuan Javën e kujdesit për personat e moshuar nën moton "Secili person i moshuar ka të drejtë" me çka bëhej matja pa pagesë e sheqerit në gjak dhe matja e shtypjes së gjakut në Shtëpinë e pensionistëve në Radovish. Qëllimi i shënimit të këtij aksioni është që të ngrihet vetëdija e popullatës për të drejtat e personave të moshuar, si dhe kujdesi i nevojshëm për ata.

## OKKK RESNJE

**"Mbledhja e mollës" prespane** - Në mënyrë tradicionale njëmbëdhjetë herë me radhë më 37 shtator të vitit 2011 në sheshin e qytetit në Resnjë, në festën fetare Dita e kryqit u mbajt "Mbledhja e mollës prespane". Në manifestim, përkaj vizitorëve dhe turistëve të shumtë, mori pjesë edhe OKKK Resnje me aksionin për dhurimin e gjakut ku dhuruan gjak 30 dhurues. U vendos edhe shtand me fletushka dhe broshura, ku rinia i promovonin aktivitetet e organizatës dhe Klubit rinor, ku në ndërkohë mobilizuan edhe 10 vullnetarë të rinj.

## OKKK Sh. NIKOLLË

**Aktivitetet të kërhëndellave me fëmijët me nevoja të posaçme** - Më 21 prill anëtarët e klubit rinor i vizituan fëmijët e qendrës për persona të hendikepuar me të cilët kishin tre orë shoqërim ku gjyrosën shumë vezë me ngjyra të llojllojshme dhe e kaluan kohën në lojë dhe argëtim.

## OKKK STRUGË

**"Shpëtimtarë në ujë"** - Organizata komunale e KK STRUGË për herë të parë në vitin 2011 organizoi trajnim për Shpëtimtarë në ujë për nevojat e plazheve të liqenit në periudhën verore. Me qëllim përfundimtar e kapaciteteve të shpëtimtarëve u siguroa pajisje e plotë për zbatimin e detyrave. Shpëtimtarët gjatë periudhës verore ishin të angazhuar vazhdimisht dhe të përgatitur që të veprojnë në rast të fatkeqësisë.

## OKKK STRUMICË

**Pjesëmarrje e Klubit rinor në "Karnavalin e Strumicës"** - Klubi i të Rinjve të OKKK Strumicë tanimë 4 vite me radhë merr pjesë në manifestimin tradicional ndërkombëtar "Karnavali i Strumicës", nëpërmjet sigurimit të çajit të ngrohtë për pjesëmarrësit, mysafirët VIP dhe për vizitorët. Në këtë aktivitet u ftuan të marrin pjesë edhe rinia e organizatave tjera komunale të KK, ku u kyçën gjithsej 83 vullnetarë të KKR-së. Në atë mbrëmje në karnaval u ndanë rreth 5 000 gota çaj për të maskuarit dhe për mysafirët.

## OKKK SHIPTIP

**"Perdja e hekurt"** - Organizata komunale e KK Shtip me ftesë të Qendrës për zhvillimin e rajonit juglindor dhe rajonit Lindor dhe Ambasadës Gjermane në Maqedoni mori pjesë në tubimin me biçikleta "Perdja e hekurt" me trajektore Berovë – Strumicë – Koleshinë. Ky tubim me biçikleta kishte për qëllim zhvillimin e potencialeve për turizmin alternativ dhe në të morën pjesë 40 biçikletistë nga Maqedonia dhe Evropa. Organizata komunale e KK Shtip mori pjesë me ekipin për ndihmë të parë dhe me automjet për në teren, i cili i shoqëronte biçikletistët gjatë gjithë rrugëtimit me biçikletë.



## KRYQI I KUQ I QYTETIT TË SHKUPIT

**Vendi i parë për ekipin nga ndihma e parë në Bukuresht** - Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit e mori arin në garën e 7-të nga Ndhimja e Parë të kryeqyteteve të Evropës Juglindore. Këtë vit nikoqiri i ngjarjes ishte Bukureshti, Rumania, në periudhën prej 15 deri më 18 shtator të vitit 2011. Nina, Vllado, Sokol, Tanja, Viktor, Kiki dhe Magde janë entuziastët e ekipit të cilët më shumë se 6 muaj dhanë kontribut me ushtrim dhe të cilët në fund u dekoruan me medalje të artë. Edhe një herë munda i përkushtuar rezultoi me sukses.

## OKKK QENDËR

**Shoqërimi dhe dhurata për vitin e ri** - Bashkëpunimi i mirë me vetëqeverisjen lokale u vërtetua edhe me aktivitete të cilat i quajtmë si "Shoqërimi dhe dhurata për vitin e ri". Gjegjesisht edhe këtë herë kryetari i komunës së Qendrës, z. Vladimir Todoroviq në mënyrë pozitive u përgjigj në kërkesën tonë dhe dhuroi 50 paqeta për vitin e ri. Këtë herë grupi qëllimor ishin fëmijët e shkollës speciale "Zlatan Sremec", për të cilët përkaj dhuratave, vullnetarët e Klubit rinor të KK Qendër u kujdesën me shfaqje të shkëlqyeshme teatrale për t'ua zbukuruar festat e vitit të ri.



## OKKK GAZI BABË

**Partneritet për bashkëpunim të përbashkët me vetëqeverisjen lokale** - Në vitin 2011 Komuna Gazi Babë e njohi organizatën komunale të KK Gazi Babë, si partner adekuat në projektet që vijojnë: "Rinia dhe përvoja – fuqia e humanitetit", "Fëmijë të shëndoshë për të ardhme më të ndritshme", "Ndhimja e parë – garë komunale", "Ndhimja e parë në çerdhe" dhe "Mobilizimi i dhuruesve të rinj të gjakut dhe afirmimi i dhurimit të gjakut". Kontribut të vet dhanë edhe Komuna Petrovec dhe Ilinden me aktivitete të shumta të realizuara në territorin e tyre, bashkëpunim me institucionet e tyre, pjesëmarrje në manifestime, donacion të paqetave ushqimore – Komuna Petrovec etj. Aktivitete të realizuara bashkarisht për përmirësimin e kushteve për jetën e popullatës vendore të këtij territori, si dhe përparim i bashkëpunimit mes veti mes OKKK Gazi Babë dhe vetëqeverisjeve lokale.

## OKKK KARPOSH

**"Dasma e Galiçicës"** - Ekipi për përgjigje gjatë katastrofave i OKKK Karposh së bashku me 40 studentë të Organizatës ndërkombëtare për këmbimin e studentëve të fakulteteve teknike në periudhën prej 15 – 17 korrik realizuan aktivitet të përbashkët nëpërmjet ngritjes së lagjes prej shatori dhe dhënie të ndihmës së parë gjatë Manifestimit "Dasma e Galiçicës" që paraqet thellimin e bashkëpunimit tanimë të zbatuar me Sektorin joqeveritar, por njëkohësisht edhe promovim i aktiviteteve dhe ngritje të imazhit të Kryqit të Kuq.

## OKKK KISELLA VODË

**Gara evropiane nga ndihma e parë në Venecia** - Në vitin 2011 ekipi i ndihmës së parë i OKKK Kisella Vodë mori pjesë në Garën evropiane nga ndihma e parë që u mbajt prej 14 deri 18 shtator në Venecia – Itali. Menjëherë pas fitores së garës shtetërore dhe marrjes së vendit të parë filluan përgatitjet e mëdha të ekipit tonë që me dinjitet ta prezantojnë shtetin dhe shoqatën nacionale në Garën evropiane, si me dituri, ashtu edhe me pajisje teknike.

## OKKK ÇAIR

**Vend të parë në garën shtetërore nga Ndhimja e parë** - Rinia e OKKK Çair këtë vit, pas orvatjeve të shumta definitivisht e fituan vendin e parë gjatë të dëshiruar në garën shtetërore nga Ndhimja e parë. Rinia e ekipit përkushtojnë vëmendje të madhe në ngritjen e vetëdijes tek rinia për rëndësinë e dhënies së Ndhimës së parë dhe në mënyrë intensive, përkaj përgatitjeve për garën evropiane nga ndihma e parë që këtë herë do të mbahet në Irlandë, ata vazhdimisht paraqesin trajnime demonstruese të rinisë së organizatës komunale dhe të shkollave.

# FALËNDERIM PËR VULLNETARËT, ANËTARËT E ORGANIZATËS, PARTNERËT DHE DONATORËT

Arritjet dhe optimizmi ynë u takojnë kontributeve dhe angazhimeve të vullnetarëve tanë, anëtarëve të organizatës, udhëheqësish, drejtorisë dhe të punësuarve dhe me të vërtetë iu falënderohemi për përkushtimin dhe kontributin e tyre për arritjet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në vitin 2011. Njëkohësisht dëshirojmë ta shprehim falënderimin tonë për përkrahjen e vazhdueshme të partnerëve tanë në vend dhe jashtë vendit, institucioneve qeveritare, organizatave joqeveritare, medimueve, ndërmarrjeve, qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

## Falënderim të posaçëm për

Federatën Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuq;  
Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq;  
Kryqit të Kuq të Gjermanisë  
Kryqit të Kuq të Baden Vürttemberg;  
Gjysmëhënës së Kuq;  
Kryqit të Kuq të Austrisë;  
Kryqi i Kuq i Spanjës;  
Ministrisë për mbrojtje;  
Ministrisë për punë dhe politikë sociale;  
Ministrisë së shëndetësisë;  
Ministrisë për punë të brendshme;  
Ministrisë për arsim dhe shkencë;  
Ambasada e Republikës së Sllovenisë  
Ambasada e Konfederatës së Zvicrës  
Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës  
Qendrës për menaxhim me kriza;  
Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim;  
Bashkësisë së njërive të vetëqeverisjes lokale;  
Entit për mbrojtje sociale;  
Fondit global;  
UNHCR;  
CIRA, Qendra për zhvillim institucional;  
OJQ Rubikon;  
OJQ Qendra për vullnetarë Shkup;  
HERA;  
Oda ekonomike e Maqedonisë;  
Lidhja e odave ekonomike e Maqedonisë;  
Oda ekonomike e Maqedonisë veriperëndimore;  
SHA Posta e Maqedonisë;  
ERA Panairi i Shkupit;

ONE;  
Operatori VIP;  
Fondacioni T-Mobile për Maqedoni;  
ALFA Banka SHA Shkup;  
Banka e Ohrit SHA Ohër – Societe Generale Group;  
Banka komerciale SHA Shkup;  
Stopanska Banka SHA Shkup;  
EVN Maqedoni SHA;  
McDonald's;  
SAVA soiguruvanje SHA Shkup;  
OKTA SHA – Shkup;  
Studio Moderna;  
Korea Auto Trejd;  
Spitali special "Filipi i Dytë";  
Adriamed;  
ALKALOID SHA Shkup;  
EVROPA 92;  
Ekonomiks plus;  
Geneks;  
Radio Televizioni i Maqedonisë;  
Televizioni SITEL;  
Televizioni Kanal 5;  
Televizioni ALSAT – M;  
Televizioni ALFA;  
Televizioni TELMA;  
Televizioni ERA;  
Televizioni MTM;  
Agjencia informative e Maqedonisë – AIM;  
Media Print Maqedoni;  
Veçer;



## RAPORT FINANCIAR PËR VITIN 2011

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë nëpërmjet raportit financiar i paraqet të hyrat dhe të dalurat e planifikuara dhe të realizuara, dhe paraqet vërtetim për implementim të suksesshëm të aktiviteteve programore dhe projektuese të përkrahura nga partnerët e vendit dhe të jashtëm të organizatës.

Puna e organizatës paraqitur nëpërmjet të dhënave financiare paraqet një vit të përfunduar me sukses me realizimin e Buxhetit prej 110.79% për dallim nga viti 2010 ku realizimi ishte 123.42%. Të hyra personale janë realizuar me 88.40% dhe shënojnë ulje në krahasim me vitin 2010 ku realizimi ishte 95.24% dhe marrin pjesë me 20.46% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara. Të hyrat nga organet dhe donatorët, paraqesin të hyra qëllimore, të cilat në pjesë të madhe në mënyrë të drejtpërdrejtë transferohen në organizatat komunale, ku përdoren për implementimin e aktiviteteve projektuese. Këto të hyra janë realizuar me 118.52% shënojnë ulje në krahasim me vitin 2010 ku janë realizuar 129.41%. Të njëjtat përfshijnë 79.54% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin 2011.

Në pjesën e të dalurave mund të vërtetohet se shpenzimi është i kontrolluar dhe qëllimor, që është qëllim kryesor i secilës organizatë. Nga të dalurat e përgjithshme të realizuara, shpenzimet funksionale gjegjësisht programore shënojnë ulje të mirë në krahasim me vitin e kaluar dhe janë 62.57%, të dalurat për rrogat e të punësuarve janë 12.66%, ndërsa shpenzimet materiale janë 24.77%. nga të dalurat e përgjithshme të realizuara, 37.59% kanë të bëjnë me nevojat e qendrës, 33.47% drejtpërsëdrejti janë të transferuara në OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit, përderisa 28.93% tjera janë mjete të cilat janë shpenzuar në të gjithë zyrën e që kanë të bëjnë për realizimin e aktiviteteve programore të OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit.


Një pjesë e tepicës së mjeteve financiare gjegjësisht dallimi pozitiv mes të hyrave dhe të dalurave janë mjete qëllimore të cilat kanë të bëjnë me projekte realizimi i së cilëve vazhdon në vitin 2012.

Nga ana e Këshillit Ekzekutiv të Kryqit të Kuq të RM-së u formua komision, i cili kryen revizion të brendshëm në punën financiare dhe materiale. Gjithashtu u angazhua revizion i jashtëm, i cili bëri revizion në pajtueshmëri me Ligjin për revizion dhe Standarde Ndërkombëtare për paraqitjen financiare dhe dispozitat e kontabilitetit të cilat vlejné në Republikën e Maqedonisë. Sipas mendimit të shtëpisë revizore, gjendja financiare e organizatës së Kryqit të Kuq të RM-së është paraqitur në mënyrë reale dhe objektive.


Raporti financiar ka të bëjë vetëm me punën e Zyrës qendrore të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.



### Të hyra në vitin 2011



### Të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin 2011





### Të hura në vitin 2011



### Të dalura në vitin 2011



### Të dalurat e realizuara në vitin 2011



	Buxheti 2011	Realizuar në 2011	%	% në 2010	
<b>TË HYRA TË PËRGJITHSHME</b>	<b>50,490,826.00</b>	<b>55,940,657.00</b>	<b>110.79</b>	123.42	
Burime personale të të hyrave	12,950,300.00	11,447,984.00	88.40	95.24	20.46
Të hyra nga organe / donator	37,540,526.00	44,492,673.00	118.52	129.41	79.54

**TË HYRA**

	PËRSHKRIM	Burime personale të të hyrave	Të hyra nga organe /donatorë	Buxheti 2011	Realizuar nga burime perosnale	Realizuar nga organe dhe donatorë	Realizuar 2011	%
<b>74</b>	<b>TRANSFERE DHE DONACIONE</b>							
741	Ministeria e Finansave ( Nga Buxheti i RM - mjete për aktivitete programore)		6,324,000.00	<b>6,324,000.00</b>		6,323,600.00	6,323,600.00	99.99
741	Dhurimi i gjakut ( Ministria e Shëndetësisë)		11,000,000.00	<b>11,000,000.00</b>		4,687,060.00	4,687,060.00	42.61
742	Veprimtari Socialo - humanitare	1,000,000.00		<b>1,000,000.00</b>	187,292.00	6,735,235.00	6,922,527.00	692.25
742	Organizim dhe zhvillim		1,857,940.00	<b>1,857,940.00</b>	109,850.00	1,416,292.00	1,603,584.00	100.00
742	Ndihma e parë	3,500,000.00		<b>3,500,000.00</b>	1,614,315.00		1,614,315.00	46.12
742	Edukim shëndetësor		4,186,022.00	<b>4,186,022.00</b>		6,050,985.00	6,050,985.00	144.55
742	Rinia	200,000.00		<b>200,000.00</b>	33,617.00	588,770.00	622,387.00	100.00
742	Katastrofa		1,612,874.00	<b>1,612,874.00</b>		2,199,042.00	2,199,042.00	136.34
742	Diseminim		318,300.00	<b>318,300.00</b>		179,177.50	179,177.50	56.29
742	KK në aksion - PVH		1,657,280.00	<b>1,657,280.00</b>		876,896.00	876,896.00	52.91
742	Informimim dhe komunikim		0.00	<b>0.00</b>			0.00	
742	Shërbimi për kërkim		120,000.00	<b>120,000.00</b>		79,639.00	0.00	0.00
742	Njësia ndërkombëtare/Bashkëpunim ndërkombëtar		0.00	<b>0.00</b>			0.00	
742	Marketing-mobilizim të fondeve		864,110.00	<b>864,110.00</b>			13,010.00	
742	Financa (të hyra tjera)/kredit për veturë/ndalesë prej të punësuarve, kamata	0.00		<b>0.00</b>	1,700,234.50	13,010.00	1,700,234.50	100.00
<b>72</b>	<b>TË HYRA PA TATIM</b>							
725	Nga OKKK ( në bazë të kotizimit)	1,875,000.00		<b>1,875,000.00</b>	193106		193,106	10.30
725	Donacion nga personat fizik	200,000.00		<b>200,000.00</b>	6,100.00	910,072.00	916,172.00	458.09
725	Donacion nga personat juridik / Shitja e veturave	650,000.00		<b>650,000.00</b>	1,011,050.00	1,516,740.00	2,527,790.00	388.89
725	Pagesë shtesë për triska ( nga ligji i KK)	300,000.00		<b>300,000.00</b>	266,746.00		266,746.00	88.92
723	Nga qiramarrja e hapësirës afariste/të hyra tjera	2,135,300.00		<b>2,135,300.00</b>	1,302,426.00		1,302,426.00	60.99
725	Nga regjistrimi i automjeteve	600,000.00	9,600,000.00	<b>10,200,000.00</b>	415,719.00	7,898,674.50	8,314,393.50	100.00
725	Qendra për Edukim Trajnim	1,490,000.00		<b>1,490,000.00</b>	179,500.00		179,500.00	100.00
725	Të hyra të transferuara nga viti i kaluar/të hyra tjera/Fondi i solidaritetit/ Fondi për zhvillim	1,000,000.00		<b>1,000,000.00</b>	4,428,028.50	5,017,480.00	9,445,508.50	
	<b>TË H Y R A TË PËRGJITHSHME</b>	<b>12,950,300.00</b>	<b>37,540,526.00</b>	<b>50,490,826.00</b>	<b>11,447,984.00</b>	<b>44,492,673.00</b>	<b>55,940,657.00</b>	110.79

	Buxheti 2011	Realizuar në 2011	%	% në 2010	
<b>TË HYRA TË PËRGJITHSHME</b>	<b>50,490,826.00</b>	<b>51,196,817.50</b>	<b>101.40</b>	0.00	
Rroga dhe kompensime për të punësuarit	8,376,000.00	6,481,149.50	<b>77.38</b>	94.03	12.66
Të dalura për materiale dhe shërbime	7,712,468.00	12,682,213.00	<b>164.44</b>	130.92	24.77
Të dalura funksionale (programore)	34,402,358.00	32,033,455.00	<b>93.11</b>	103.80	62.57

## TË DALURA

PËRSHKRIM	Nga burime personale	Nga organe dhe donatorë	Buxheti 2011	Realizuar nga burime personale	Realizuar nga organe dhe donatorë	Realizuar në 2011	%
<b>TË DALURA VIJUESE</b>							
<b>401 RROGA ELEMNTARE DHE KOMPENSIME</b>	8,326,000.00	0.00	8,326,000.00	6,397,417.50	0.00	6,397,417.50	76.84
4800 Bruto rrogë për të punësuarit	8,226,000.00		<b>8,226,000.00</b>	6,326,208.50		6,326,208.50	76.91
4012 Kompensim për pushim vjetor			<b>0.00</b>			0.00	
4012 Kompensime tjera	100,000.00		<b>100,000.00</b>	71,209.00		71,209.00	71.21
<b>402 TË ARDHURA NGA RROGAT DHE TATIMI PERSONAL</b>	50,000.00	0.00	50,000.00	65,431.00	18,301.00	83,732.00	167.46
<b>TË DALURA TË PËRGJITHSHME PËR RROGA</b>	<b>8,376,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>8,376,000.00</b>	<b>6,462,848.50</b>	<b>18,301.00</b>	<b>6,481,149.50</b>	<b>77.38</b>
<b>420 TË DALURA PËR RRUGË DHE MËDITJE</b>	200,000.00	0.00	200,000.00	940,233.00	101,054.00	1,041,287.00	520.64
<b>421 SHËRBIME KOMUNALE</b>	700,000.00	0.00	700,000.00	832,508.50	0.00	832,508.50	118.93
<b>422 PËR NXEMJE</b>	600,000.00	0.00	600,000.00	1,204,699.00	0.00	1,204,699.00	200.78
<b>423 KOMUNIKIM DHE TRANSPORT</b>	1,350,000.00	223,033.00	1,573,033.00	1,449,727.00	556,196.00	2,005,923.00	127.52
<b>423 MATERIALE</b>	1,674,000.00	4,611,855.00	6,285,855.00	1,782,090.00	3,309,904.00	5,091,994.00	81.01
<b>424 MIRËMBAJTJE TËL VAZHDUESHME</b>	500,000.00	0.00	500,000.00	730,568.00	241,851.00	972,419.00	194.48
<b>425 SHËRBIME KONTRATUESE</b>	4,182,968.00	4,230,316.00	8,413,284.00	5,191,689.50	6,635,315.50	11,827,005.00	140.58
<b>426 TË DALURA TJERA OPERATIVE</b>	350,000.00	0.00	350,000.00	303,244.00	2,646,110.00	2,818,484.00	805.28
<b>463 TRANSFERE NË ORGANIZATA JOPROFITABILE</b>	0.00	22,616,695.00	22,616,695.00	0.00	17,137,879.00	17,137,879.00	75.78
<b>TË DALURA TË PËRGJITHSHME VIJUESE</b>	<b>9,556,968.00</b>	<b>31,681,899.00</b>	<b>41,238,867.00</b>	<b>12,434,759.00</b>	<b>30,628,309.50</b>	<b>43,063,068.50</b>	<b>104.11</b>
<b>TË DALURA KAPITALE</b>							
<b>483 BLERJE TË MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRE</b>	285,000.00	40,959.00	325,959.00	380,824.50	316,248.00	697,072.50	213.85
<b>483 BLERJE TË AUTOMJETEVE</b>	0.00	0.00	0.00	920,820.00	0.00	920,820.00	100.00
<b>481 MIRËMBAJTJE ELEMENTARE DHE SPECIALE</b>	550,000.00	0.00	550,000.00	17,707.00	17,000.00	34,707.00	6.31
<b>TË DALURA TË PËRGJITHSHME VIJUESE</b>	<b>835,000.00</b>	<b>40,959.00</b>	<b>875,959.00</b>	<b>1,319,351.50</b>	<b>333,248.00</b>	<b>1,652,599.50</b>	<b>188.66</b>
<b>TË DALURA TË PËRGJITHSHME</b>	<b>18,767,968.00</b>	<b>31,722,858.00</b>	<b>50,490,826.00</b>	<b>20,216,959.00</b>	<b>30,979,858.50</b>	<b>51,196,817.50</b>	<b>101.14</b>

DALLIMI	Buxheti 2011	Realizuar 2011	%
	0.00	4,743,839.50	33.47
Shërbimi financiar Zhaklina Popoviq	Sekretar gjeneral m-r Sait Saiti	transfere në OKKK shpenzime për qendrën shpenzime nga qendra për OKKK	17,137,879.00 19,246,115.50 14,812,823.00 51,196,817.50
			37.59 28.93



Udhëheqësisë së  
KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
SHKUP

## RAPORT I REVIZORIT TË PAVARUR

Ne realizuam revizion në raportet e paraqitura financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" (në tekstin e mëtejme Organizatë), të cilat e kyçin Bilansin e gjendjes në ditën 31 dhjetor të vitit 2011, si dhe Bilansit të të hyrave dhe të dalurave dhe Raporti për ndryshime në fondin afarist për vitin i cili mbaron në atë ditë dhe shqyrtimin e politikave kontabiliste më të rëndësishme dhe shënimeve tjera sqaruese.

Raportet e paraqitura financiare për vitin 2011 përbëhen prej raporteve për punën e rregullt të Organizatës si dhe raportet për projektet: 1) Fushatë për HIV/SIDA; 2) Forumi SEE për adaptim në ndryshime klimatike; 3) Zhvillim i përbashkët i bashkësisë; 4) Mbindërtim intensiv të kapaciteteve; 5) Fondi global për mbajtjen e prevalencës së ulët të HIV/SIDA në RM-së; 6) Fondi global për përforcimin e preventivës, diagnostikës dhe trajtimit të tuberkulozit; 7) federata Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe; 8) Kryqi i Kuq i Spanjës; 9) Kryqi i Kuq i Gjermanisë (9 projekte) dhe raportet për dy fonde: 1) Fondi për zhvillim dhe 2) Fondi për solidaritet. Projektet janë të financuara nga donatorë të posaçëm dhe të njëjtit realizohen nëpërmjet nënlogarive të posaçme (qëllimore) të Organizatës. Për ato Organizata nuk përgatit raporte të posaçme financiare.

### **Përgjegjësi të menaxhmentit për raportet financiare**

Menaxhmenti i Organizatës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të këtyre raporteve financiare në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprotabile dhe me Standardet ndërkombëtare kontabiliste për sektorin publik në bazë të gatshme të shpallur në RM-së. Kjo përgjegjësi kyç: formim, implementim dhe mbajtje të kontrollit interno që është relevante për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare të cilat janë të liruara nga paraqitja e gabueshme materiale, pa dallim se a janë rezultat i mashtrimit apo gabimit, zgjedhje dhe zbatim të politikave adekuate kontabiliste, si dhe vlerësim kontabiliteti që janë të kapshme në rrethinë.

### **Përgjegjësia e revizorit**

Përgjegjësia jonë është ta shprehim mendimin për këto raporte financiare në bazë të revizionit tonë. Revizionin e zbatuam në pajtueshmëri me Standardet ndërkombëtare për revizion ato standarde kërkojnë t'i respektojmë kërkesat etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë revizionin që të marrim besim të kuptueshëm për atë se a janë të liruara raportet financiare nga prezantimi i gabueshëm material.

Revizioni kyç zbatimin e procedurave për grumbullimin e dëshmimeve revizore për shumat dhe paraqitjet në raportet financiare. Procedurat e zgjedhura nga vendimet e revizorit, kyçur edhe vlerësimin e rreziqeve nga paraqitja e gabueshme materiale të raporteve financiare, pa dallim se a është rezultat i mashtrimit apo gabimit. Kur i bën ato vlerësime të rrezikut, revizori e shqyrton kontrollin interno relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare që të mer formën e procedurave revizore të cilat janë adekuate me rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së mendimit për efektivitetin e kontrollit intern. Revizioni gjithashtu kyç edhe vlerësimin e përpunueshmërisë së politikave të përdorura kontabiliste dhe të kuptueshmërisë së vlerësimeve kontabiliste të bëra nga ana e menaxhmentit, si dhe vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm të raporteve financiare.

Ne besojmë se dëshmitë revizore të cilat i kemi mbledhur janë të kapshme dhe adekuate që të sigurojmë bazë për mendimin tonë si revizor.

### **Mendimi i revizorit**

Sipas mendimit tonë, raportet e prezantuara financiare të "KRYQIT TË KUQ REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" e paraqesin në mënyrë reale dhe objektive në të gjitha aspektet e rëndësishme, gjendjen financiare të organizatës në ditën e 31 dhjetorit të vitit 2011, si dhe rezultatet e punës së sajdie ndryshimet në fondet për vitet të cilat mbarojnë atë ditë, në pajtueshmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprotabile dhe Standardet kontabiliste ndërkombëtare për sektorin publik në bazë të gatshme të shpallur në Republikën e Maqedonisë.

Shkup, 02 mars 2012

  
Drejtues  
Dragan Dimitrov



  
Revizor i autorizuar  
Zvonko Kočovski





[www.redcross.org.mk](http://www.redcross.org.mk)

